



**ODA  
E FARMACISTËVE  
TË KOSOVËS**

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA



**ADVANCING  
PHARMACY  
WORLDWIDE**

**AZHURNUAR NGA FIP MË 19 MARS 2020**

**KËSHILLA SHËNDETËSORE NGA FIP**

**Shpërthimi i Coronavirus SARS – CoV-2/  
PANDEMIA COVID-19**

**Informata dhe udhërrëfyes  
për farmacistët dhe personelin në barnatore**

**Federata Ndërkombëtare e Farmacisë**

**Përkthyer dhe përshtatur: Oda e Farmacistëve të Kosovës  
(Dr.Sc. Arianit Jakupi, Mr.Ph. Dardana Mehaj)**

**22 Mars 2020**

## Përmbajtja

<b>Qëllimi i këtij dokumenti .....</b>	<b>4</b>
<b>Përgjegjësitë dhe roli i farmacistëve komunitarë .....</b>	<b>4</b>
<b>Përgjegjësitë dhe roli i barnatoreve spitalore .....</b>	<b>5</b>
<b>Përhapja e koronavirusit .....</b>	<b>5</b>
<b>Cka është koronavirusi? .....</b>	<b>5</b>
<b>Cka është shpërthimi i koronavirusit SARS-CoV-2? .....</b>	<b>6</b>
<b>Si transmetohet koronavirusi SARS-CoV-2? .....</b>	<b>7</b>
<b>SARS-CoV-2 Sëmundja e frymëmarrjes akute - informacion klinik .....</b>	<b>8</b>
<b>Fillimi .....</b>	<b>8</b>
<b>Simptomat .....</b>	<b>8</b>
<b>Parandalimi .....</b>	<b>12</b>
<b>Aktivitetet e barnatores .....</b>	<b>13</b>
<b>Masat parandaluese .....</b>	<b>16</b>
<b>Përdorimi i maskave .....</b>	<b>17</b>
<b>Mbrojtja e frymëmarrjes (pajisje personale mbrojtëse) .....</b>	<b>20</b>
<b>Këshillë për komunitetin .....</b>	<b>20</b>
<b>Rekomandim për kujdesin e pacienteve ambulator .....</b>	<b>21</b>
<b>Referimi dhe izolimi .....</b>	<b>24</b>
<b>Kujdesi në shtëpi për pacientët me infeksion të dyshuar SARS-CoV-2 që paraqesin simptoma të lehta .....</b>	<b>25</b>
<b>Barnatorja si burim i informacionit .....</b>	<b>25</b>
<b>Testimi laboratorik për SARS-CoV-2 në rastet e dyshuara te njerëzit .....</b>	<b>25</b>
<b>Kontrolli i infeksionit: larja e duarve .....</b>	<b>26</b>
<b>Si të përgatisni formulimet me bazë alkoli .....</b>	<b>27</b>
<b>Menaxhimi i pastrimit dhe dezinfektimit .....</b>	<b>27</b>
<b>Kontrolli i infeksionit: masat tjera të përkujdesjes .....</b>	<b>28</b>
<b>Shqetësimet lehtësuese: udhëtimi .....</b>	<b>29</b>
<b>Personeli i barnatores .....</b>	<b>30</b>
<b>Përgjigje për pyetje të shpeshta nga popullata dhe pacientët .....</b>	<b>30</b>
<b>Ç'është koronavirusi i ri? .....</b>	<b>30</b>
<b>Cili është burimi i SARS-CoV-2? .....</b>	<b>30</b>
<b>Si përhapet virusi? .....</b>	<b>31</b>
<b>A është SARS-CoV-2 i njëjtë me virusin MERS-CoV ose SARS? .....</b>	<b>32</b>

<b>Kam temperaturë dhe kollë. A mund të jetë koronavirusi i ri?</b> .....	32
<b>Çka mund të bëj për të mbrojtur veten nga infeksioni?</b> .....	32
<b>A ka ndonjë bar specifik për të parandaluar ose trajtuar SARS-CoV-2?</b> .....	32
<b>A ju mbrojnë vaksinat kundër pneumonisë kundër SARS-CoV-2?</b> .....	33
<b>A janë antibiotikët efektivë në trajtimin e SARS-CoV-2?</b> .....	33
<b>A janë maskat mjekësore të efektshme për të më mbrojtur nga infeksioni?</b> .....	34
<b>Unë kam qenë në vendet e prekura dhe kam diarre. A mund të jetë SARS-CoV-2?</b> .....	35
<b>A mund të përhapin kafshët shtëpiake në shtëpi SARS-CoV-2?</b> .....	35
<b>Demantimi i miteve</b> .....	36
<b>Burime shtesë të informacionit dhe bibliografia</b> .....	38
<b>Burime tjera të informacionit</b> .....	42
<b>Validiteti</b> .....	42
<b>SHTOJCA 1: Lista e barnave kryesore për trajtimin e infeksioneve SARS-CoV-2</b> .....	43
<b>SHTOJCA 2: Lista e pajisjeve kryesore, dhe pajisjeve mbrojtëse personale të infeksioneve SARS-CoV-2</b> .....	44
<b>SHTOJCA 3: Udhërrëfyes i OBSH për prodhimin lokal të formulimeve për pastrimin e duarve – prodhimi në laboratorët galenike të barnatoreve</b> .....	45
<b>SHTOJCA 4: Lista e dezinfektantëve për objektet që zankonisht kontaminohen me infeksionet me SARS-CoV-2</b> .....	48
<b>Falenderime</b> .....	49

### **Qëllimi i këtij dokumenti**

Që nga dhjetori i vitit 2019, shpërthim i koronavirusi të ri njerëzor është përhapur në shumë vende dhe shkaktoi mijëra raste dhe vdekje. COVID-19 është sëmundja e shkaktuar nga virusi i ri SARS-CoV-2. Shumica e personave të infektuar kanë simptoma të lehta të frymëmarrjes që do të zhduken vetvetiu, por disa njerëz zhvillojnë sëmundje më të rëndë, si pneumoni. Virusit transmetohet përmes kontaktit me një person të infektuar ose përmes pikave/spërkave të frymëmarrjes kur një person i infektuar kollitet ose teshtit. Ekziston rrezik më i lartë i infeksionit nëse keni qenë në një zonë ku virusi po përhapet, ose nëse keni qenë në kontakt të ngushtë me një person të infektuar me koronavirusin e ri. Ekziston gjithashtu rrezik më i lartë nëse aktualisht vuani edhe nga ndonjë sëmundje tjetër apo komorbiditetet.

Qëllimi i këtij dokumenti është sigurimi i informacionit dhe direktivave përkatëse për shpërthimet e koronavirusit - dhe veçanërisht koronavirus SARS-CoV-2 dhe sëmundjen që e shkakton COVID-19 - për farmacistët dhe personelin e barnatores, si në kontekst të kujdesit parësor (d.m.th. barnatoret komunitare dhe institucionet e kujdesit parësor shëndetësor) po ashtu edhe për farmacistët të cilët punojnë në mjediset spitalore, si dhe për farmacistët që punojnë si biokimistë në laboratore, dhe ofrojnë një seri referencash që mund të konsultohen për më shumë informata.

Infeksionet me koronavirus mund të parandalohen dhe shpërthimi mund të ndalet përmes angazhimit aktiv të vendimmarrësve, profesionistëve shëndetësorë, mediave dhe komunitetit, siç tregohet në shpërthimet e mëparshme të koronavirusit, siç është në vitin 2003 me SARS-CoV (Sindromi i rëndë akut i frymëmarrjes - i shkaktuar nga koronavirusi) ose në vitin 2012 me MERS-CoV (Sindroma e frymëmarrjes në Lindjen e Mesme - i shkaktuar nga koronavirusi). Ky dokument synon të ndihmojë farmacistët dhe personelin në barnatore në parandalimin e përhapjes së sëmundjes dhe të kontribuojë në menaxhimin e saj efikas në sistemin shëndetësor.

### **Përgjegjësitë dhe roli i farmacistëve komunitarë**

Barnatoret komunitare në vendet e prekura nga sëmundja dhe vendet e paprekura janë shpesh pika e parë e kontaktit me sistemin shëndetësor për personat me shqetësime të lidhura me shëndetin ose thjesht që kanë nevojë për informacion dhe këshilla të besueshme.

Farmacistët komunitarë kanë përgjegjësinë e përbashkët për:

- Ruajtja e stoqeve të mjaftueshme të produkteve medicinale (barna, maska, etj)
- Informimi dhe edukimi i publikut
- Këshillimi
- Referimi
- Promovimi i parandalimit të sëmundjes
- Promovimi i kontrollit të infeksionit

Përveç roleve të lidhura me COVID-19, barnatoret ofrojnë një shërbim publik esencial për tërë popullatën përmes furnizimit me barna dhe ofrimit të kujdesit farmaceutik. Sigurimi i vazhdimësisë së këtyre shërbimeve është thelbësor.

Në disa vende, si Franca dhe Portugalia, farmacistët janë autorizuar të bëjnë dispensim më afatgjatë të barnave të përshkruara për pacientët me sëmundje kronike, për të zvogëluar nevojën për vizita mjekësore në mënyrë që të mos e ngarkojnë sistemin shëndetësor më shumë.

Shoqata e Farmacistëve Amerikanë gjithashtu u ka kërkuar siguriesve shëndetësorë dhe menaxherëve të barnatoreve që menjëherë të heqin dorë nga pengesat administrative.

## **Përgjegjësitë dhe roli i barnatoreve spitalore**

Barnatoret spitalore në vendet e prekura nga shpërthimi i virusit dhe në vendet ku nuk ka shpërthyer virusi luajnë një rol të rëndësishëm në:

- Ruajtja dhe furnizimi me stoqe të mjaftueshme të produkteve dhe pajisjeve mjekësore për të përmbushur nevojat e sistemit shëndetësor
- Bashkëpunim me profesionistë të tjerë të kujdesit shëndetësor në ofrimin e kujdesit ndaj pacientëve
- Promovimi i parandalimit dhe kontrollit të infeksioneve në spitale
- Informimi dhe këshillimi
- Sigurimi i përdorimit të përgjegjshëm të produkteve medicinale. Për shembull, duke siguruar që profesionistët e kujdesit shëndetësor ti vënë vazhdimisht maskat e tyre në mënyrë korrekte për të shmangur kontaminimin.
- Farmakovigjilenca dhe monitorimi i rezultateve.

Gjatë pandemisë, përveç barnatoreve në komunitet dhe roleve të lidhura me COVID-19, barnatoret spitalore ofrojnë një shërbim esencial për pacientët (si pacientët e hospitalizuar, ashtu edhe për pacientët ambulatorë) dhe ekipet e kujdesit shëndetësor përmes furnizimit me barna dhe kujdes farmaceutik. Sigurimi i vazhdimësisë së këtyre shërbimeve është esencial.

## **Përhapja e koronavirusit**

### **Cka është koronavirusi?**

Koronaviruset (CoVs) janë një familje e madhe e viruseve që shkaktojnë sëmundje duke filluar nga ftohja e zakonshme deri te sëmundjet më të rënda siç janë Sindroma e Frymëmarrjes në Lindjen e Mesme (MERS-CoV) dhe Sindroma e Rëndë Akute e Frymëmarrjes (SARS-CoV). Koronavirusi i ri (nCoV) është një lloj i ri i virusit i cili nuk është identifikuar më parë tek njerëzit.

Koronaviruset janë zoonotikë, që do të thotë se ato transmetohen midis kafshëve dhe njerëzve. Hulumtimet e detajuara zbuluan se SARS-CoV ishte transmetuar nga macet te njerëzit dhe MERS-CoV nga devetë dromedare te njerëzit. Disa koronaviruset të njohura po qarkullojnë te kafshët që nuk kanë infektuar ende njerëz.

Koronaviruset janë viruse të mëdha, të mbështjellura, me fije pozitive të ARN-së. Ata kanë gjenomin më të madh në mesin e të gjitha viruseve të ARN-së. Gjenomi është i vendosur brenda një kapsidi spiral të formuar nga proteina nukleokapsidë dhe më tej mbështillet. Të shoqëruar me mbështjellësin viral janë të paktën tri proteina strukturore: proteina e membranës dhe proteina e mbështjellësit, ndërsa proteina e tretë me zgjatim ndërmjetësor hyrjen e virusit në qelizat e nikoqirit. Në mesin e proteinave strukturore, kjo e treta formon zgjatime të mëdha nga sipërfaqja e virusit, duke i dhënë koronavirusit pamjen e kurorës (pra emri i tyre; korona në latinisht do të thotë kurorë). Përveç ndërmjetësimit të hyrjes së virusit, zgjatimi është një përcaktues kritik i nikoqirit të virusit dhe tropizmit të indeve dhe një nxitës kryesor i përgjigjes imune të nikoqirit. (Li, 2016)

Koronaviruset zakonisht prekin gjitarët dhe zogjtë, duke shkaktuar një sërë sëmundjesh vdekjeprurëse. Në përgjithësi, koronaviruset shkaktojnë sëmundje të përhapura të sistemit të frymëmarrjes, gastrointestinale dhe të sistemit nervor qendror tek njerëzit dhe kafshët, duke kërcënuar shëndetin e njeriut dhe duke shkaktuar humbje ekonomike për shkak të kalimit të infeksionit nga ai i lehtë i rrugëve të sipërme në ato të poshtme të traktit respirator. (Li, 2016)

Koronaviruset janë të afta të përshtaten në mjedise të reja përmes mutacionit dhe rekombinimit me lehtësi relative. (Li, 2016) Si e tillë, ato mund të ndikojnë si nikoqir dhe në inde të reja.

Për këtë arsye, megjithëse rrallë, koronaviruset të caktuara që zakonisht prekin vetëm specie të caktuara të kafshëve mund të gjenerojnë shtame të reja që mund të kalojnë te njerëzit dhe më pas të transmetohen midis njerëzve. Meqenëse njerëzit nuk ishin ekspozuar ndaj virusëve të tilla më parë dhe nuk mund të mbroheshin nga vaksinat ekzistuese ose imuniteti natyror, këto mutacione mund të çojnë shpejt në shpërthim sëmundjesh dhe, përfundimisht, në pandemi. Kështu ndodhi me shpërthimet e mëparshme të SARS dhe MERS.

### **Këtu është shpërthimi i koronavirusit SARS-CoV-2?**

SARS-CoV-2 është një shtam i koronavirusit që u zbulua për herë të parë në qytetin Wuhan, në provincën e Hubei, në Republikën Popullore të Kinës - një qytet me një popullsi prej 11 milion. Përhapja filloi si një pneumoni e agjentit të panjohur kauzal në fund të dhjetorit 2019.

Analizat filogjenetike të ndërmarra me sekuenca të gjenomit të plotë në dispozicion sugjerojnë që lakuriqët duket se janë rezervuari i virusit që shkakton COVID-19, por nikoqiri (et) i ndërmjetëm ende nuk është identifikuar. (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2020)

Më 30 Janar 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) shpalli shpërthimin si Urgjencë e Shëndetit Publik në rang të Shqetësimit Ndërkombëtar. OBSH rekomandoi që emri i përkohshëm i sëmundjes që shkakton shpërthimin e tanishëm të jetë sindromi rëndë akut i frymëmarrjes 2019-nCoV. Në akronimin 2019-nCoV, "2019" është viti kur u zbulua për herë të parë virusi, "n" do të thotë "i ri – nga novel", dhe "CoV" korrespondon me familjen koronavirus.

Më 11 shkurt 2020, Komiteti Ndërkombëtar i Taksonomisë së Viruseve (ICTV) vendosi që ta emërojë virusin si sindromë të rëndë akute të frymëmarrjes koronavirus 2 (SARS-CoV-2), dhe OBSH më në fund vendosi që sëmundjen e shkaktuar nga ky virus ta emërojë si COVID-19 (për sëmundjen Coronavirus të identifikuar në vitin 2019).

Pas shpërthimeve të mëdha të sëmundjes në shumë vende, dhe me mijëra vdekje në të gjithë botën, më 11 mars 2020 OBSH shpalli shpërthimin pandemi.

Për shifrat e azhuruara të numrit të rasteve të konfirmuara dhe vdekjeve, si dhe të dhënave demografike dhe epidemiologjike mbi pandeminë, mund të konsultoheni në faqen e internetit <https://www.worldometers.info/coronavirus/> dhe / ose faqen në internet të krijuar nga Qendra për Shkencë dhe Inxhinieri e Sistemeve në Universitetin Johns Hopkins.

Virusi duket se tashmë ka ndryshuar pas transmetimit të tij origjinal nga rezervoari i kafshëve tek njerëzit, duke çuar në të paktën dy shtame të ndryshme. Analizat gjenetike të popullsisë së 103 gjenomave të SARS-CoV-2 treguan se këto viruse evoluon në dy lloje kryesore (të përcaktuara L dhe S). Edhe pse lloji L (~70%) është më i përhapur se lloji S (~30%), lloji S u konstatua se ishte versioni bazë. (Xiaolu Tang, 2020)

Përderisa të dy llojet bëjnë pjesë në shpërthimin e tanishëm, përhapja më e madhe e llojit L tregon se ky lloj është më agresiv. Sidoqoftë, është e rëndësishme të mbani në mend që viruset ndryshojnë gjatë gjithë kohës dhe që jo të gjitha mutacionet janë tregues i ashpërsisë së sëmundjes ose shkallës së transmetimit. Në fakt, dallimet midis dy llojeve të koronavirusit të ri janë aq të vogla sa studiuesit nuk

kanë dëshirë t'i bëjnë madje klasifikimin e tyre si shtame të ndara. Duke pasur parasysh që grupe të shumta në të gjithë botën po punojnë për një vaksinë, të dish numrin e saktë të shtameve (ose llojet) e virusit është esenciale sepse, për të qenë efektive, vaksina eventuale do të duhet të kete cak tiparet të cilat janë të pranishme në të gjitha shtamet e njohura (ose llojet). Për fat të mirë, shumë nga ndryshimet gjenetike të identifikuar nuk duket se ndikojnë në prodhimin e proteinave, do të thotë se nuk duhet të ketë ndryshime të rëndësishme në mënyrën se si funksionon virusi ose simptomat që ai shkakton. (Technology.org, 2020)

### **Si transmetohet koronavirusi SARS-CoV-2?**

Transmetimi i SARS-CoV-2 ndodh nga mekanizmat e mëposhtëm:

- a) Më shpesh, përhapet nga personi në person midis kontakteve të ngushta (rreth 6 feet / 1,8 metra).
- b) Përhapja nga personi në person mendohet të ndodhë kryesisht përmes pikave (spërkave) të frymëmarrjes të prodhuara kur një person i infektuar kollitet ose teshtin, ngjashëm se si përhapen gripi dhe patogjenët tjerë të frymëmarrjes.
- c) Këto pika mund të kalojnë në gojë, hundë ose sy të njerëzve që janë afër ose mund të inhalohen në mushkëri.
- d) Mund të jetë e mundshme që personi të marrë COVID-19 përmes prekjes së sipërfaqeve apo objekteve që kanë virusin në to dhe pastaj duke prekur gojën e tyre, hundën apo sytë, pork jo nuk është mënyra e vetme se si përhapet virusi (Qendra për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes, 2020) Shih gjithashtu seksionin "Menaxhimi i pastrimit dhe desinfektimit)
- e) Në mënyrë tipike, me shumicën e viruseve të frymëmarrjes, njerëzit mendohet se janë më ngjitës kur janë më simptomatikë (më të sëmurët). Sidoqoftë, me SARS-CoV-2, ka pasur raporte për përhapjen edhe kur ka pasur kontakt me pacientë të infektuar por asimptomatik. (Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, 2020) (Rothe, 2020). Studimet më të reja se pacientët asimptomatik (apo parasimptomatik) mund të jenë ata që bëjnë shpërhapjen rapide të sëmundjes (Ruiyun Li, 2020).
- f) Gjithashtu, pacientët mund të mbeten ngjitës deri në dy javë pas kalimit të simptomave. Sipas Wölfel me bashkëpunëtorë, megjithëse simptomat zhdukën kryesisht në fund të javës së parë, ARN virale mbetee e zbulueshme në strishot e grykës edhe në javën e dytë. Mostrat e fecesit dhe pështymës mbeten ARN-pozitive për periudha edhe më të gjata, përkundër eliminimit të plotë të simptomave. (Roman Wölfel, 2020)
- g) Ka shumë pak informata që janë në dispozicion në lidhje me COVID-19 gjatë shtatëzënësise. Transmetimi intrauterin ose perinatal nuk është identifikuar. Në dy raporte që përfshinin gjithsej 18 gra shtatzëna me pneumoni nga COVID-19 të dyshuar ose të konfirmuar, nuk kishte asnjë evidencë laboratorike për transmetimin e virusit në neonat. Sidoqoftë, dy raste neonatale të infeksionit janë të dokumentuara. Në një rast, diagnoza u bë në ditën e 17 pas lindjes, pas kontaktit të ngushtë me nënën e foshnjës dhe maminë, të cilat të dyja ishin të infektuara me virusin. Rasti tjetër u diagnostikua 36 orë pas lindjes; burimi dhe koha e transmetimit në atë rast ishin të paqarta. (McIntosh, sëmundja Coronavirus 2019 (COVID-19) - Situata speciale: Gratë shtatzëna, 2020) Pjesa më e madhe e këshillave në vende të ndryshme, siç është Britania e Madhe, për gratë shtatzëna që lëvizin në izolime sociale është më shumë parandaluese se e bazuar në evidencë se ka rritje të rrezikut apo dëmtimit.
- h) Në studime të kufizuara për gratë me COVID-19 dhe një tjetër infeksion koronavirus, Sindromi i Rëndë Akut i frymëmarrjes (SARS-CoV), virusi nuk është zbuluar në qumështin e gjirit; megjithatë

nuk dihet nëse nënat me COVID-19 mund ta transmetojnë virusin përmes qumështit të gjirit. Qumështi i gjirit siguron mbrojtje ndaj shumë sëmundjeve.

- i) Ka përjashtime të rralla kur ushqyerja me gji ose ushqyerja me qumësht të gjirit (të nxjerrë përemis pompës – expressed breast milk) nuk rekomandohet. CDC nuk ka udhëzime specifike për ushqyerjen në gji gjatë infeksionit me viruse të ngjashme si SARS-CoV ose Sindromi i frymëmarrjes së Lindjes së Mesme (MERS-CoV) gjithashtu të dy koronaviruset. Në një situatë të ngjashme me COVID-19, CDC rekomandon që një nënë me grip të vazhdojë ushqyerjen në gji ose të ushqejë qumështin e gjirit të nxjerrë me pompë më herët) tek foshnja e saj, ndërsa merr masa paraprake për të shmangur përhapjen e virusit tek foshnja e saj. Duke pasur parasysh shkallët e ulëta të transmetimit të viruseve të frymëmarrjes përmes qumështit të gjirit, Organizata Botërore e Shëndetit aktualisht deklaron se nënat me COVID-19 mund të ushqejnë foshnjat në gji. (Akademia e Mjekësisë së Ushqyerjes në Gji, 2020)

## **SARS-CoV-2 Sëmundja e frymëmarrjes akute - informacion klinik**

### **Fillimi**

SARS-CoV-2 ka një periudhë inkubacioni 2 deri 14 ditë para fillimit të simptomave.

Një studim i udhëhequr nga hulumtues në Shkollën e Shëndetit Publik Johns Hopkins Bloomberg dha një vlerësim se periudha mesatare e inkubacionit të sëmundjes është 5.1 ditë. Kjo kohë mesatare nga ekspozimi deri në shfaqjen e simptomave sugjeron që periudha 14-ditore e karantinës e rekomanduar nga OBSH dhe organizatat e tjera është e arsyeshme. Analiza tregon që rreth 97.5% e njerëzve që zhvillojnë simptoma të infeksionit SARS-CoV-2 do ta bëjnë këtë brenda 11.5 ditëve nga ekspozimi. Studiuesit vlerësuan se për çdo 10,000 individë të karantinuar për 14 ditë, vetëm rreth 101 do të zhvillojnë simptoma pasi të jenë lëshuar nga karantina. (Lauer SA, 2020).

### **Simptomat**

Për rastet e konfirmuara me COVID-19, sëmundjet e raportuara mund të jenë njerëzit me pak ose pa simptoma deri te njerëzit që janë të sëmurë rëndë dhe po vdesin. Simptomat mund të përfshijnë (në pranimin në spital) (Nanshan Chen, 2020):

- Temperaturë (> 80% e pacientëve)
- Kollë (> 80%)
- Vështirësi në frymëmarrje (31%)
- Dhembje muskulore (11%)

Sëmundja gjithashtu mund të shfaqet vetëm me simptoma të lehta, duke përfshirë: temperaturë të shkallës së ulët, kollë, diskomfort, rinorrhe, dhembje të grykës pa shenja paralajmëruese, të tilla si gulçim ose vështirësi në frymëmarrje, rritje të sekrecioneve të frymëmarrjes (p.sh. sputum ose hemoptizë), simptoma gastrointestinale si nauze, të vjella dhe / ose diarre dhe pa ndryshime në gjendjen mendore (d.m.th konfuzion, letargji). (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2020)

Të dhënat paraprake raportojnë vdekshmëri 11% të pacientëve të hospitalizuar. Komplikimet ndodhën në 33% të pacientëve, dhe përfshinin: sindromën akute të rëndë të frymëmarrjes (ARDS) (17%), dëmtimin akut të veshkave, dëmtimin akut të frymëmarrjes, shokun septik dhe pneumoninë. (Nanshan Chen, 2020)



Faktorët e rrezikut për sëmundje të rënda nuk janë ende të qarta, megjithëse pacientët më të moshuar ose pacientët me sëmundje themelore mjekësore (diabeti, hipertensioni, sëmundja kardiovaskulare, kanceri) mund të jenë me rrezik më të lartë. Në rastet më të rënda, infeksioni mund të shkaktojë pneumoni, sindromë të rënda akute të frymëmarrjes, dëmtim të veshkave dhe madje edhe vdekje. (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2020)

Sëmundja tek fëmijët duket të jetë relativisht e rrallë dhe e lehtë me afërsisht 2.4% të totalit të rasteve të raportuara mes individëve të moshës nën 19 vjeç. Një pjesë shumë e vogël e atyre të moshës nën 19 vjeç kanë zhvilluar sëmundje të rënda (2.5%) ose kritike (0.2%). (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2020)

### **1. Barnat për trajtim klinik**

Aktualisht, nuk ka asnjë bar specifik ose vaksinë për koronavirus SARS-CoV-2 dhe asnjë bar ose vaksinë nuk janë testuar plotësisht për sigurinë dhe efikasitetin.

Aktualisht, kryesisht përdoret terapia antivirale, si dhe trajtimi simptomatik dhe mbështetës bazuar në gjendjen klinike të pacientit. Trajtimet mbështetëse përfshijnë terapinë me oksigjen, hidratimin, kontrollin e temperatureës / dhembjes dhe antibiotikët në rast të bashkë-infeksionit bakterial.

Sipas diagnozës dhe planit të trajtimit të rekomanduar nga autoritetet shëndetësore kineze, barnat antivirale që mund të testohen për trajtim përfshijnë kryesisht  $\alpha$ -Interferon (terapi inhalimi aerosol), lopinavir / ritonavir, ribavirin, fosfat klorokine, umifenovir dhe të tjera. Autoritetet sugjerojnë vlerësim të mëtejshëm të efikasitetit të barnave të rekomanduara të cilat janë aktualisht në aplikimet klinike.

Për sa i përket imunoterapisë, për pacientët me sëmundje të rënda të mushkërive dhe në testimin laboratorik me niveleve të ngritura të IL-6, tocilizumab mund të provohet për trajtim. Nuk rekomandohet që të përdorni tre ose më shumë barna antivirale në të njëjtën kohë. Dhe udhëzimet përkatëse të diagnozës dhe trajtimit theksojnë shmangien e përdorimit të pabazuar ose të paarsyeshëm të barnave antibakteriale ose glukokortikoideve. (Komisioni Kombëtar i Shëndetit i Republikës Popullore të Kinës, 2020)

Në raportin e rastit të parë të pacientëve COVID-19 në Shtetet e Bashkuara të botuar në NEJM, simptomat e pacientit u përmirësuan ndjeshëm pas marrjes së Remdesivir. (Michelle L. Holshue, 2020)

Në një studim të bërë nga profesor Li Lan-juan dhe ekipi i tij, janë krahasuar efektet antivirale të kombinimit të trefishtë (umifenovir + interferon rekombinant  $\alpha$ -2b + lopinavir / ritonavir) dhe kombinimi i dyfishtë (interferon rekombinant  $\alpha$ -2b + lopinavir / ritonavir). Rezultatet e studimit treguan se kombinimi i trefishtë përfshirë umifenovir shkurton ndjeshëm kohën negative të acidit nukleik të virusit të frymëmarrjes dhe kohën mesatare të hospitalizimit. (Wei Runan, 2020)

Gjithashtu, profesori Li Lan-juan dhe ekipi i XU Kai-jun vlerësuan efektin e dozave të ulëta dhe të mesme të glukokortikoideve në pastrimin e virusit. Rezultatet e studimit treguan se doza të ulëta dhe të mesme të glukokortikoideve nuk e shkurton ndjeshëm kohën mesatare në shndërrim negativ të acidit nukleik të virusit të frymëmarrjes dhe kohës mesatare për të përmirësuar diagnozën në rengenin mushkërive. Asnjë përfitim domethënës nuk u vërejt kur klasifikimi ishte i kufizuar te pacientët me COVID-19. (Ni Qin, 2020)

Si përmbledhje, shumica e studimeve të publikuara aktualisht përqendrohen në hulumtimin epidemiologjik COVID-19 ose analizën e karakteristikave klinike. Ende ka pak studime për të vlerësuar

efektivitetin / sigurinë e barnave, dhe studimet e janë akoma në fazën e hulumtimit klinik. Kur përdorni barnat e lartpërmendura të mundshme për të trajtuar COVID-19, është e nevojshme që të formuloni me kujdes regjimin e dozimit dhe të monitoroni nga afër sigurinë dhe efektivitetin e barit për të shmangur reaksionet anësore ose ndërveprimet e barnave.

Për raste të lehta në komunitet, pacientët këshillohen të qëndrojnë në shtëpi në izolim, përveç për pacientët të cilët mund të jenë në rrezik më të madh të zhvillimit të formave të rënda të sëmundjes, përfshirë edhe të moshuarit (> 65 vjeç në disa vende, > 70 në të tjerët), njerëz me sëmundje të tjera (si sëmundjet kardiovaskulare, diabeti, sëmundjet e frymëmarrjes si COPD, ose kanceri) dhe pacientët me imunitet të kompromentuar (kongjenital ose të fituar).

Menaxhimi i simptomave mund të përfshijë përdorimin e antipiretikëve dhe / ose barnave anti-inflamatore për temperaturë dhe dhimbje të lehta. Siguria e përdorimit të ibuprofenit tek pacientët COVID-19 është vënë në dyshim nga një artikull i publikuar nga The Lancet duke sugjeruar që pacientët që trajtohen me barna që rrisin shfaqjen e enzimës konvertuese të angiotenzinës 2 (ACE2) mund të jenë në rrezik të rritur nga infeksioni dhe / ose sëmundja e rëndë COVID-19. (Lei Fang, 2020) ACE2 është vërtetuar se ndërmjetëson hyrjen e qelizave nga SARS-CoV-2 në një publikim tjetër (Markus Hoffmann, 2020). Sidoqoftë, dëshmia kundër përdorimit të ibuprofenit te pacientët me COVID-19 nuk është aq e mbështetur mirë sa ta përjashtojë përdorimin. Në praktikën e përgjithshme klinike, ibuprofeni ka një efikasitet të vendosur mirë në kontrollin e simptomave për të cilat është treguar, si në sëmundje infektive të lehtë ashtu dhe të rënda. Aktualisht nuk ka dëshmi përfundimtare për të krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë midis përdorimit të barnave anti-inflamatore jo-steroidë (përfshirë ibuprofen) dhe rritjes së rrezikut të infeksionit ose ashpërsisë së sëmundjes. (Agjensia Evropiane e Barnave, 2020) Sidoqoftë, barna të tjera si paracetamoli / acetaminofeni mund të konsiderohen për administrimin e temperaturës te pacientët me COVID-19 nëse është e përshtatshme.

Po ashtu, nuk ka asnjë dëshmi që të mbështesë pohimin dhe se trajtimi me frenuesit ACE (ACEi) ose bllokuesit e receptorëve të angiotenzinës (ARB) mund të predispozojnë individët për rezultate të pafavorshme nëse ata infektohen me COVID-19. Shoqata të ndryshme shkencore dhe profesionale kanë deklaruar që pacientët duhet të vazhdojnë trajtimin me ACEi dhe ARB përveç nëse këshillohen në mënyrë specifike që të ndalen nga ekipi i tyre mjekësor. (Shoqata Britanike Kardiovaskulare dhe Shoqata Britanike për Dështim të Zemrës, 2020)

Kortikosteroidet nuk rekomandohen në mënyrë rutine për pneumoni virale ose sindromë akute të rëndë të frymëmarrjes (ARDS) dhe duhet të shmangen për shkak të mundësisë për zgjatjen e replikimit viral siç është vërejtur te pacientët MERS-CoV, përveç nëse indikohet për arsye të tjera (p.sh., përkeqësimi i COPD, shoku septik refraktar duke ndjekur Udhëzimet e Fushatës për Mbijetim nga Sepsa). (Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, 2020) (Russell CD, 2020)

Për një racionalitet për mundësi të ndryshme trajtimi, si dhe udhëzime për trajtimin e grupeve të veçanta (paciente shtatzëna, të porsalindur, fëmijë dhe të rinj) dhe mbështetje nutritive, shihni dokumentin udhëzues (në anglisht ose kinezisht) të përgatitur nga Shoqata Farmaceutike Kineze, gjithashtu në dispozicion nga faqja e dedikuar FIP. (Shoqata Farmaceutike Kineze, 2020)

Informacione të mëtejshme në nivel vendi nga vendet në Evropë janë në dispozicion në uebfaqen e Shoqatës Evropiane të Farmacistëve Spitalorë.

## 2. Terapia plazmatike konvalescente

Për pacientët me COVID-19 me përparim të shpejtë të sëmundjes, sëmundje të rëndë dhe kritike, mund të provohet terapi konvalescente plazmatike (CPT) (Komisioni Kombëtar i Shëndetit i Republikës Popullore të Kinës, 2020). CPT përdor një titër të caktuar të antitropave specifik për virusin në plazmën e individit konvalescent për të mundësuar pacientin që merr infuzionin të marrë imunitet pasiv dhe të largojë patogjenët nga qarkullimi i gjakut. Kjo metodë është përdorur me sukses në trajtimin e gripit SARS dhe H1N1, dhe është një trajtim efektiv (Chen L, 2020).

Përdorimi i trajtimit të CPT mund të ndjekë parimet e mëposhtme (Komisioni Kombëtar i Shëndetit i Republikës Popullore të Kinës, 2020):

1. Në parim, kursi i sëmundjes nuk i kalon tri javë. Gjithashtu, pacienti duhet të ketë një test pozitiv të acidit nukleik viral ose viremi të vërtetuar nga ekspertët klinikë.
2. Pacientët me sëmundje të rëndë me përparim të shpejtë të sëmundjes, ose pacientë me sëmundje kritike në fazën e hershme, ose pacientë të vlerësuar në mënyrë gjithëpërfshirëse nga ekspertët klinikë se kërkojnë terapi plazmatike. Doza e infuzionit përcaktohet sipas situatës klinike dhe peshës së pacientit, zakonisht doza e infuzionit është 200-500 ml (4-5 ml / kg).

Para, gjatë dhe pas infuzionit, duhet të bëhen regjistrime të hollësishme dhe vëzhgime klinike për të vlerësuar efektet anësore të infuzionit plazmatik. Llojet kryesore të reaksioneve anësore të transfuzionit përfshijnë mbingarkesë të qarkullimit të lidhur me transfuzionin, dëmtim akut të mushkërive të lidhura me transfuzion, dispne të lidhura me transfuzion, reaksione alergjike, reaksione hipotensioni të lidhura me transfuzion, reaksione febrile jo hemolitike, reaksione akute hemolitike të transfuzionit dhe reaksione të vonuara transfuzive hemolitike, reaksion infektiv i transfuzionit, të tjera / të panjohura, etj.

## 3. Përparimet në zhvillimin e vaksinave për trajtimin e COVID-19

Meqenëse procesi i zhvillimit të vaksinave përfshin procedura të tilla si izolimi dhe përzgjedhja e shtamit të virusit, eksperimentet in vitro, eksperimentet e kafshëve, provat klinike dhe aprovimi administrativ, kërkon shumë kohë. Aktualisht, ka disa njohuri për SARS-CoV-2 dhe mund të përdoren për zhvillimin e vaksinave (Ahmed SF, 2020) (Ramaiah A, 2020).

Ministria e Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës Popullore të Kinës ka organizuar njësi kryesore kombëtare për të realizuar hulumtime të përbashkëta, dhe ka rregulluar paralelisht pesë rrugë teknike, duke përfshirë vaksinat e inaktivuara, vaksinat rekombinante të gjeneruara gjenetikisht, vaksinat e vektorit adenovirus, vaksinat e acidit nukleik (vaksina mRNA dhe vaksina e ADN-së), dhe vaksinat e bëra nga vektorët e vaksinave virale të gripit. Disa vaksina kanë hyrë në fazën e kërkimit për sigurinë dhe efektivitetin tek kafshët eksperimentale. Pritet që deri në prill të vitit 2020, sipas ligjeve dhe rregulloreve përkatëse kombëtare, disa vaksina të hyjnë në hulumtime klinike ose përdorim urgjent. (Sun C, 2020)

## 4. Progresi i provave klinike për trajtimin e COVID-19

Aktualisht, projektet e hulumtimeve klinike mbi barnat e reja të pneumonisë koronavirus janë duke vazhduar. Që nga ora 9 e mëngjesit, më 8 Mars 2020, gjithsej 436 prova klinike u nxorrën nga Regjistri Klinik i Hulumtimeve Klinike, dhe u ekzaminuan gjithsej 181 hulumtime klinike që përfshijnë trajtimin e

barnave, nga të cilat 107 ishin hulumtime të kontrolluara të rastit, katër ishin studime reale botërore, dhe 70 ishin prova të kontrolluara jo të rastit.

Nga 181 studime, 176 u iniciuan nga institucionet kineze të kërkimit, kryesisht të shpërndara në Hubei (43), Shanghai (25), Pekin (20), Zhejiang (20) dhe Guangdong (19). Pesë studimet e mbetura u iniciuan nga vende të tjera.

Barnat e përfshira në studimet klinike kryesisht përfshijnë ato në mjekësinë tradicionale kineze (TCM) (64 artikuj), barna antivirale (40 artikuj), imunoterapi (28 artikuj, si Interferon, Thymosin, Immunoglobulin, frenuesit PD1, etj.), Barnat anti- malarike (21 artikuj, të tilla si klorokina, hidrosilklorokina, fosfati i klorokinës), glukokortikoide (6 artikuj), dhe barna të tjera (22 artikuj, si vitamina C, vitamina D, injeksion i polimioçitevet, sulfat i zinkut, acetilcisteinë, etj.).

Testimet më të shumta klinike të barnave antivirale janë barnat anti-HIV (14 artikuj, të tilla si lopinavir / ritonavir, darunavir / cobistastat, azivudine), pasuar nga barnat e viruseve anti-influenca (13, të tilla si umifenovir, fapilavir), dhe pesë hulumtime klinike të remdesivir, për të cilin konsiderohet se ka efikasitet të mundshëm kundër COVID-19.

### **Sigurimi i stokut të produkteve dhe pajisjeve medicinale**

Duke synuar parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve të infeksioneve SARS-CoV-2, barnatoret duhet të garantojnë furnizimin e barnave, përfshirë ato të përdorura për parandalimin e sëmundjeve, diagnostikimin dhe trajtimin, si dhe për furnizimin e ekipeve të ndihmës mjekësore.

Barnatoret duhet të caktojnë një farmacist që të marrë përsipër blerjen, ruajtjen dhe shpërndarjen e barnave kryesore, dhe të rregullojë stoqet sipas nevojës për të garantuar furnizimin për praktikën klinike.

Lista përfshin barna antivirale, agjentë antimikrobikë, antipiretikë dhe analgjezikë, kortikosteroide dhe disa kategori të tjera të barnave.

Shihni tabelën e zhvilluar nga Shoqata Farmaceutike Kineze në Shtojcën 1. Për një listë të pajisjeve kryesore, pajisjeve dhe pajisjeve mbrojtëse personale, të zhvilluara gjithashtu nga Shoqata Kineze Farmaceutike, shihni Shtojcën 2.

Në situata të mbajtjes në shtëpi të pacientëve ose personave nën karantinë, barnatoret mund të luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e qasjes në barna përmes dërgesave në shtëpi, jo vetëm për trajtimin e COVID-19, por edhe të gjendjeve të tjera, kronike të sëmundjeve jo ngjitëse.

### **Parandalimi**

Për të ndihmuar kontrollin e përhapjes së mëtutjeshme të virusit, njerëzit që dyshohen ose konfirmohen se kanë sëmundje duhet të izoloohen nga pacientët e tjerë dhe të trajtohen nga punonjësit e shëndetit duke përdorur masa të rrepta të kontrollit të infeksionit.

Personat të cilët kanë pasur kontakte me individë simptomatikë me infektion të konfirmuar me COVID-19 duhet të përcillen përmes ekipeve lokale të kujdesit shëndetësor.

Rekomandimet standarde të OBSH-së për publikun e gjerë për të zvogëluar ekspozimin dhe transmetimin e kësaj sëmundje dhe sëmundjeve të tjera të frymëmarrjes janë si më poshtë; të cilat përfshijnë higjienën e frymëmarrjes dhe të duarve, dhe praktikatat e sigurta të ushqimit:

1. Pastroni shpesh duart duke përdorur sapun apo përgatesa me bazë alkooli ose sapun dhe ujë;
2. Kur kolliteni dhe teshtitni mbuloni gojën dhe hundën me një bërryl ose faculete - hedhni faculetën menjëherë dhe lani duart;
3. Shmangni kontaktin e ngushtë me këdo që ka temperaturë dhe kollë;
4. Nëse keni temperaturë, kollë dhe vështirësi në frymëmarrje kërkoni kujdes mjekësor sa më parë dhe ndani historinë e mëparshme të udhëtimit me ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor;
5. Kur vizitoni tregjet në zonat që përjetojnë aktualisht raste të koronavirusit të ri, shmangni kontaktin e drejtpërdrejtë të pambrojtur me kafshë të gjalla dhe sipërfaqe në kontakt me kafshët;
6. Konsumimi i produkteve shtazore të papërpunuara ose të pjekura duhet të shmanget. Mishi i papjekur, qumështi ose organet e kafshëve duhet të trajtohen me kujdes, për të shmangur kontaminimin me ushqime të papjekura, sipas praktikave të mira të sigurisë ushqimore. (Organizata Botërore e Shëndetit, 2020)

### **Vetë-izolimi nga personat me simptoma dhe / ose personat që mund të kenë qenë në kontakt me persona të infektuar**

Vetë-izolimi nënkupton shmangien e situatave ku mund të infektonit njerëz të tjerë. Kjo do të thotë të gjitha situatat kur mund të kontaktoni me të tjerët, siç janë tubimet sociale, vendet e punës, shkollat, qendrat e kujdesit për fëmijët / parashkollorët, universitetet, tubimet me bazë besimi, institucionet e kujdesit për të moshuarit dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor, burgjet, tubimet sportive, supermarkete, restorante, qendra tregtare dhe të gjitha tubimet publike. (Ministria e Shëndetësisë e Zelandës së Re, 2020)

### **Aktivitetet e barnatores**

#### **Operacionet e barnatores: garantimi i sigurisë dhe vazhdimësia e shërbimeve**

#### **Mbikëqyrja profesionale / farmacisti përgjegjës**

Në rast se farmacisti përgjegjës nuk mund të sigurojë praninë dhe rolin e tij / saj në barnatore, këto mund të merren nga një farmacist i dytë i cili mund ti përkasë ose nuk i përket personelit të barnatores. Ky farmacist “i dytë” duhet të marrë përgjegjësinë për mbikëqyrjen e të gjitha veprimtarive të barnatores dhe tërë personelit.

### **Orari i barnatores**

Në rast se një barnatore nuk mund të sigurojë orët e saj normale të hapjes për shkak të mos disponueshmërisë së stafit për shkak të COVID-19, orët e reja të hapjes duhet t'i komunikohen publikut në një vend të dukshëm të paktën jashtë barnatores. Orari i ri duhet të sigurojë shërbime minimale për komunitetin në funksion të furnizimit me barna.

## **Shërbimi i pacientit / klientit**

Për të siguruar vazhdimësinë e furnizimit të barnave dhe shërbimeve për komunitetet ku ekziston vetëm një barnatore në një rreze të caktuar (e cila mund të ndryshojë nga një vend në tjetrin), kontakti me pacientët / klientët duhet të minimizohet duke shpërndarë barna përmes një dritareje të vogël në mur ose në derë, si ato që përdoren shpesh për shërbime të natës.

Një mburojë plastike gjithashtu mund të vendoset përpara zonës së dispensimit, ose shenja të vendosura në tokë për të treguar distancën rreth 2 m në mes të klientëve dhe personelit. Në rast se asnjë nga këto masa nuk është e mundur, pacientët / klientët nuk duhet të hyjnë në barnatore dhe farmacistët këshillohen të përdorin pajisje të përshtatshme mbrojtëse individuale, kur është e nevojshme.

Barnaret në përgjithësi këshillohen gjithashtu të bëjnë dispensimin e barnave përmes kësaj dritare sa herë që kjo mund të jetë e nevojshme për të minimizuar kontaktin duke siguruar vazhdimësinë e shërbimit.

Në mënyrë që të shmanget përqendrimi i njerëzve brenda barnatores, pacientët dhe klientët duhet të kërkohet që të presin radhën e tyre jashtë farmacisë. Në çdo rast, pacientët / klientët duhet të mbajnë një distancë prej 1-2 metrash mes tyre duke pritur në radhë.

## **Furnizimi me barna**

Gjatë furnizimit të barnatores me barna, kjo të bëhet pa lejuar hyrjen e personave që nuk janë personel i barnatores brenda në barnatore – ose së paku jo në pjesët e barnatores që nuk janë për publikun. Për më tepër, kutitë e përdorura nga shpërndarësit me shumicë për shpërndarjen e barnave duhet të pastrohen dhe dezinfektohen para se të futen brenda ambienteve të barnatores.

## **Dërgimi i barnave në shtëpi – kjo duhet të shqyrtohet nga autoritetet në Kosovë**

Për të siguruar furnizimin e duhur të barnave për pacientët dhe publikun, dhe veçanërisht në qytetet e vogla ku mund të jenë mbyllur barnaret, barnaret e hapura mund të organizojnë shpërndarjen e barnave në shtëpi. Barnaret që janë në gjendje të ofrojnë këtë shërbim inkurajohen ta bëjnë këtë, veçanërisht për pacientët që mund të jenë në karantinë ose izolim në shtëpi, ose të cilët mund t'i përkasin një grupi më të lartë rreziku ose kanë reduktim të mobilitetit.

Në rastin e dërgesave në shtëpi, personi përgjegjës për dërgesën aktuale duhet të shmangë çdo kontakt të drejtpërdrejtë me pacientin dhe gjësendet e tyre personale. Barnat dhe sendet e tjera mund të lihen jashtë derës së pacientit / klientit ose në një vend tjetër të caktuar, dhe dorëzuesi duhet të lëvizë për të mbajtur një distancë të sigurt prej 1-2 metrash duke siguruar vizualisht që barnat merren nga pacienti ose një personi i autorizuar.

Federata Italiane e Pronarëve të Farmacive në Komunitet (FEDERFARMA) vendosi një partneritet me Kryqin e Kuq Italian për një shërbim të ofrimit falas 24 orë në ditë për pacientët më të vjetër se 65 vjeç ose në karantinë ose në shtëpi. (Federfarma, 2020)

Kur është e përshtatshme dhe e mundur, barnatoret komunitare mund të bashkëpunojnë me spitalet në dhënien e barnave të nevojshme. (INFARMED - Autoridade Nacional do Medicamento e Produtos de Saúde, 2020)

### **Zona e frekuentimit**

1. Qasja në produkte në vetë-përzgjedhjen nga klientët duhet të kufizohet për të shmangur shumë njerëz që prekin këto produkte. Kjo duhet të jetë e qasshme vetëm nga personeli i barnatores.

### **Njoftim për pacientët / klientët**

Vendosni një njoftim në hyrje të barnatores me rekomandimet kryesore që pacientët / klientët duhet të miratojnë përpara se të hyjnë, siç janë:

1. Dezinfektoni duart kur hyni në barnatore;
2. Sigurohuni që të mbani një distancë prej 1-2 metrash midis jush dhe klientëve të tjerë dhe kujt do që është në personelin e barnatores;
3. Mos ecni jashtë shenjave të dyshemesë, nëse ka;
4. Nëse teshtitni ose kolliteni, mbulonni hundën dhe gojën me faculetë (të cilën duhet ta hidhni në një enë të përshtatshme dhe të mos e përdorni përsëri) ose me një bërnyll të përkulur;
5. Shmangni shtrëngimin e duarve dhe kontaktet deri sa jeni në barnatore;
6. Përgatitni paraprakisht recetat që duhet të merrni.

### **Në recepturë**

1. Kur është e mundur, caktoni një punonjës për stacion ose recepturë dhe shmangni shkëmbimet.
2. Në banak/recepturë të mbahen vetëm gjësendet esenciale.
3. Fshini dhe dezinfektoni banakun pas çdo klienti / pacienti.
4. Mbani pranë vetes një dezinfektues me bazë alkool, për të dezinfektuar duart pasi të përfundoni shërbimin me secilin pacient / klient.
5. Kur është e mundur, inkurajoni pacientët që të porosisin barnat e tyre përmes faqes në internet të barnatores (varësisht nga legjislacioni) dhe t'i dorëzohen në shtëpi apo punë.

### **Distancimi shoqëror**

1. Kufizoni numrin e pacientëve / klientëve që hyjnë në barnatore në çdo kohë.
2. Mbani një distancë të sigurt prej të paktën 1 metër (preferohet më shumë) kur shërbeni një pacient.
3. Nëse është e nevojshme, për të marë recetat, dorëzuar barnat dhe për të bërë pagesën mund të përdoret ndonjë mjet në mënyrë që të tejkaloni këtë distancë.
4. Këshilloni pacientët të mbajnë një distancë të sigurt prej të paktën 1 metër midis tyre derisa presin, dhe të përdorni shenja në dysheme për të treguar se ku mund të qëndrojnë;



### **Këshilloni pacientët / klientët që:**

1. Shmangin qëndrimet e gjata në barnatore.
2. Shmangin vizitat në barnatore nëse janë të moshuar ose kanë komorbiditete. Kurdo që të jetë e mundur, pacientë të tillë duhet të kërkojnë nga një anëtar i familjes, një mik apo një fqinj që të shkojë në barnatore në vend të tyre. (Associação Nacional das Farmácias de Portugal, 2020)

### **Rekomandime për shërbime farmaceutike dhe aktivitete në barnatore**

1. Testet e kujdesit (matja e tensionit të gjakut, kolesterolit, glikemia), testet e shtatëzënësisë, ose administrimi i vaksinave dhe injeksioneve (kudo që është i autorizuar), dhe çdo shërbim tjetër që kërkon kontakt të drejtpërdrejtë me një pacient duhet të ndjekë masa shtesë mbrojtëse, siç është përdorimi i maskës dhe dorëzave.
2. Shërbimet e përmendura në pikën e mësipërme mund të kufizohen ose ndërpriten nëse ato mund të paraqesin një rrezik për shëndetin e personelit (p.sh., për pacientët me simptoma të infeksionit të frymëmarrjes).

### **Rekomandime për ekipin e barnatores**

1. Për të siguruar vazhdimësinë e aktiviteteve në barnatore, rekomandohet që ta ndani ekipin në ndërrime (për shembull, një në mëngjes dhe një pasdite), me mbylljen e mundshme të barnatores midis tyre, të dezinfektoni të gjithë barnatoren, duke siguruar që anëtarët e secilit ndërrim nuk kalojnë njëri-tjetrin.
2. Personeli me sëmundje që komprometojnë sistemin e tyre imunitar duhet të përdorin maska dhe mundësisht të kryejnë detyra tjera si ato administrative. Masat e higjienës së duarve duhet të përforcohen.
3. Personeli duhet të ndërrojë uniformën më shpesh.
4. Duhet të shmangët vënia e aksesorëve si byzylyk, orë dhe unaza.
5. Kurdo që është e nevojshme të vini maskë, higjiena dhe dezinfektimi i duarve duhet të bëhet para dhe pas.

### **Masat parandaluese**

Farmacisti dhe personeli i barnatores mund të luajnë një rol kyç në parandalimin e përhapjes së koronavirus SARS-CoV-2 nga:

- Të kuptuarit e natyrës së sëmundjes, si transmetohet dhe si ta parandalohet përhapja e mëtejshme;
- Të dish të qasësh në burimet e informacionit në nivelin kombëtar lidhur me strategjitë COVID 19 (përfshirë qendrën më të afërt të referimit për COVID-19), dhe duke ruajtur qasjen në atë informacion;
- Informimi, këshillimi dhe edukimi i komunitetit;
- Furnizimi i produkteve të përshtatshme;
- Inkurajimi i individëve dhe familjeve me raste të dyshuara të COVID-19 që të vet-izolohen në shtëpi nëse simptomat janë të lehta dhe për pacientët që nuk i përkasin grupeve me rrezik të



lartë (mbi 65 vjeç , gjendje shoqëruese kardiovaskulare apo respiratore, diabet, kancer apo sëmundje tjetër kongjenitale apo e fituar që mund ta komprometojë sistemin imun). Pacientët të ciët i përkasin këtyre grupeve duhet të referohen në një institucion adekuat shëndetësor për teste të metejme dhe përcjellje adekuate.

Qendrat e kujdesit parësor, barnatoret ose institucionet tjera të kujdesit shëndetësor (përfshirë ato të mjekësisë tradicionale) që nuk kanë një mjedis dhe pajisje të tillë mund të luajnë një rol kryesor në parandalimin e sëmundjes, por ato nuk janë institucionet e duhura për të trajtuar ose menaxhuar pacientët me COVID-19.

Përpjekja për të trajtuar pacientët në mjedise joadekuate mund të rrezikojë profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe të tjerët.

Për më tepër, masat e mëposhtme duhet të merren parasysh nga farmacisti pergjegjes (Shoqata Farmaceutike Kineze, 2020):

1. Zhvilloni plane emergjente dhe definoni proceset e punës
2. Kryeni trajnime të plota për personelin
3. Përqendrohuni në gjendjen shëndetësore të farmacistëve
4. Mbroni personelin e barnatores
5. Forconi monitorimin e infeksioneve nga farmacistët
6. Siguroni një menaxhim adekuat të pastrimit dhe dezinfektimit
7. Fuqizoni menaxhimin adekuat të pacientit
8. Fuqizoni edukimin e pacientëve
9. Fuqizoni menaxhimin e ekspozimit ndaj infeksionit
10. Fuqizoni menaxhimin e mbetjeve mjekësore

Udhëzimi i detajuar për secilën pikë jepet nga Shoqata Kineze Farmaceutike në dokumentin e duhur që mund të gjendet në faqen e dedikuar FIP.

### **Përdorimi i maskave**

Venia e një maskë mjekësore është një nga masat parandaluese për të kufizuar përhapjen e disa sëmundjeve të frymëmarrjes, përfshirë COVID-19, në zonat e prekura. Sidoqoftë, përdorimi i maskës pa masat tjera është i pamjaftueshëm për të siguruar një nivel të duhur mbrojtjeje dhe duhet të merren masa të tjera po aq të rëndësishme.

Nëse vendoset në mënyrë adekuate, maska mdihmon në bllokimin e sekrecioneve respiratore të prodhuara nga personi që ka vënë maskën që të mos kontaminonjë personat tjerë dhe sipërfaqet (shpesh quhet kontrolli i burimit). (Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve 2020). Nëse do të përdoren maska, kjo masë duhet të kombinohet me higjienën e duarve dhe masat e tjera të kontrollit të infeksionit dhe parandalimit për të parandaluar transmetimin nga COVID-19 nga njeriu tek njeriu.

OBSH rekomandon që punonjësit e kujdesit shëndetësor duhet:

- Vendosni një maskë mjekësore kur hyni në një dhomë ku pacientët të dyshuar ose të konfirmuar se janë të infektuar me COVID-19 pranohen dhe në çdo situatë të kujdesit të ofruar për një rast të dyshuar ose të konfirmuar;
- Përdorni një maskë respiratore të paktën po aq mbrojtëse sipas Institutit Kombëtar i SHBA për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (NIOSH) të konstatuar N95, Standardin e Bashkimit Evropian (BE)

FFP2, ose ekuivalent, kur kryeni procedura të gjenerimit të aerosolit, siç është intubimi i trakesë, ventilim jo invasiv, trakeotomi, ringjallje kardiopulmonare, ventilim manual para intubimit dhe bronkoskopisë.

Qendra e SHBA për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) kanë lëshuar udhëzime për tre faktorët kryesorë që një frymëmarrës të jetë efektiv:

1. Respiratori duhet të vihet siç duhet dhe të vihet gjatë ekspozimit.
2. Respiratori duhet të përshtatet mirë në fytyrën e përdoruesit për të siguruar që nuk ka boshllëqe midis lëkurës së përdoruesit dhe vulës së frymëmarrësit.
3. Filtri respiratorit duhet të kapë më shumë se 95% të grimcave nga ajri që kalon nëpër të. (Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve)

Për udhëzime mbi përdorimin e saktë (dhe të pasaktë) të frymëmarrësve, shihni broshurën e cituar CDC.

### **Kur të përdoret maska**

- Nëse jeni is hëndoshë ju duhet ta vendosni maskën vetëm nëse kujdeseni për një person i cili dyshohet se ka infeksion me COVID-19.
- Vendoseni maskën nëse kolliteni apo teshtitni
- Maskat janë efektive vetëm kur kombinohen me larje të shpeshtë të duarve me dezinfektues me bazë alkooli apo me ujë dhe sapun.
- Nëse mbani maskë atëherë ju duhet të dini se si ta vendosni dhe si ta hiqni në mënyrë adekuate (Organizata Botërore e Shëndetësisë 2020)

### **Si ta vendosni, përdorni, hiqni dhe hidhni maskën**

1. Mos harroni, një maskë duhet të përdoret nga punonjësit e shëndetit, ofruesit e kujdesit dhe individët me simptoma të frymëmarrjes, si temperatureë dhe kollë.
2. Para se të prekni maskën, pastroni duart me një dezinficiens me bazë alkooli ose sapun dhe ujë
3. Merrni maskën dhe inspektojeni atë për të çara dhe vrima.
4. Orientonjeni në anën e sipërme (ku është shiriti metalik).
5. Siguroni anën e duhur të jashtme të maskës (anën me ngjyrë).
6. Vendoseni maskën në fytyrën tuaj. Vendosni shiritin metalik ose skajin e ngurtë të maskës në mënyrë që të formësohet në formën e hundës tuaj.
7. Tërhiqeni poshtë fundin e maskës në mënyrë që të mbulojë gojën dhe mjekrën.
8. Pas përdorimit, hiqni maskën; hiqni pjesën elastike nga prapa veshëve duke e mbajtur maskën larg fytyrës dhe rrobave, për të mos prekur sipërfaqet potencialisht të kontaminuara të maskës.
9. Hidhni maskën në një shportë të mbyllur, menjëherë pas përdorimit.
10. Bëni higjenën e duarve pasi prekni ose hidhni maskën. Përdorni dezinficines me bazë alkooli ose nëse janë të ndotura dukshëm, lani duart tuaja me sapun dhe ujë (Organizata Botërore e Shëndetit, 2020)

Maskat mjekësore mund të përdoren për të parandaluar dhe përhapur infeksionet respiratore

Janë dy lloje të maskave mjekësore: **maskat e fytyrës dhe respiratorët**



**Maskat e fytyrës** janë më të shpura dhe parandalojnë atë që e vë nga përhapja e pjesëzave të mëdha dhe spërkave kur kolliten dhe testijnë.

**N95 respiratorët** janë më të shtrëngueshëm dhe parandalojnë atë që e vë nga inhalimi i grimcave t[ vogla infektive. Respiratorët N95 nuk rekomandohet që të përdoren nga publiku i përgjithshëm.

### Maskat e fytyrës duhet t përdoren nga

- Individët me simptoma të infeksionit respirator si kollitje, teshtitje, dhe ndonjëherë temperaturë
- Personeli shëndetësor
- Personat që përkujdesen për dikë apo në kontakt të ngushtë me dikend që ka infeksion respirator

### Si ta përdor maskën e fytyrës

- 1 Laji duart për së paku 20 sekonda para se ta vësh maskën e fytyrës
- 2 Vëre maskën e fytyrës mbi hundë dhe gojë. Sigurohu që të jetë e shtrenguar, të mos ketë hapësira dhe siguro lidhëset elastike.



- 3 Mos e prek pjesën e përparme të maskës. Nëse e bën, laji duart për së paku 20 sekonda.
- 4 Hiqe maskën pa e prekur pjesën e përparme. Hidhe në shportë të mbyllur
- 5 Laji duart përsëri për së paku 20 sekonda.



Image credits: Angel N. Desai, and Preeti Mehrotra. JAMA, 2020-03-04. doi:10.1001/jama.2020.2331

### Mbrojtja e frymëmarrjes (pajisje personale mbrojtëse)

Përdorni një mbrojtës të frymëmarrjes (d.m.th., një respirator) që është të paktën po aq mbrojtës sa respirator N95 me filtër i testuar nga NIOSH dhe i certifikuar për një përdorim, para se të hyni në dhomën e pacientit ose në zonën e kujdesit.

Rrespiratorët një përdorimësh duhet të hiqen dhe të hudhen pasi të dilni nga dhoma e pacientit apo nga zona e kujdesit dhe të mbyllet dera. Kryeni higjenën e duarve pasi hidhni respiratorin.

Nëse përdoren respiratorë të ripërdorshëm (p.sh., respirator për pastrimin e ajrit me energji elektrike / PAPR), ato duhet të pastrohen dhe dezinfektohen sipas udhëzimeve të prodhuesit para ripërdorimit.

Përdorimi i respiratorit duhet të jetë në kontekstin e një programi të plotë të mbrojtjes së respiratorit, në përputhje me standardet e mbrojtjes dhe Sigurisë në Punë (OSHA) – standardi i respiratorëve. Personeli duhet të trajnohet në mënyrë medicinale dhe të testohet në përdorimin e respiratorëve (p.sh. N95 një përdorimësh certifikuar nga NIOSH) dhe të trajnohen në përdorimin e duhur të respiratorëve, heqjen dhe largimin e sigurt dhe kundërpikimet mjekësore ndaj përdorimit të respiratorit.




Image credits: Ronald Shaffer, PhD; Jaclyn Krah Cichowicz, MA; Ginger Chew, ScD; and LCDR Joy Hsu, MD, MS. CDCs, 2018. <https://blogs.cdc.gov/niosh-science-blog/2018/01/04/respirators-public-use/>

### Këshillë për komunitetin

Individët pa simptoma të frymëmarrjes duhet:

1. Shmangni tubimet e mëdha dhe hapësirat e mbyllura të mbushura me njerëz;
2. Mbani një distancë prej të paktën 1 metër nga çdo individ me COVID-19 (p.sh., kollitja, teshtitja);
3. Kryeni higjenën e duarve shpesh, duke përdorur bazë alkooli apo me sapun dhe ujë kur duart janë të ndotura dukshëm;
4. Nëse kolliteni ose teshtitni mbuloni hundën dhe gojën me bërryl të përkulur ose faculetë, hidhni faculetën menjëherë pas përdorimit dhe kryeni higjenën e duarve;
5. Shmangni preken e gojës, hundës dhe syve para se të lani duart.
6. Shmangni vizitat e njerëzve të moshuar në shtëpitë e tyre apo në shtëpitë e të moshuarve pasi ata janë shumë më të ndjeshëm ndaj COVID-19



Maskat mjekësore nuk janë të nevojshme, pasi nuk ka prova për dobinë e saj për të mbrojtur personat që nuk janë të sëmurë. Sidoqoftë, maska mund të vendosen në disa vende sipas zakoneve apo kulturës lokale. Nëse përdoren maska, duhet të ndiqen praktikat më të mira se si të vendosni, hiqni dhe depozitoni ato dhe veprimet e higjienës së duarve pas heqjes (shihni më poshtë këshillat në lidhje me menaxhimin e duhur të maskave).

Individët me simptoma të frymëmarrjes duhet të:

1. Vendosin maskë mjekësore dhe kërkonin kujdes mjekësor nëse keni temperaturë, kollë dhe vështirësi në frymëmarrje, sa më shpejt të jetë e mundur ose në përputhje me protokollet lokale;
2. Ndiqni këshillat më poshtë në lidhje me menaxhimin e duhur të maskave.

Vendosja e maskave mjekësore kur nuk ka indikacione mund të shkaktojë kosto të panevojshme, shton barrën e prokurimit dhe krijoni një ndjenjë të rremë të sigurisë që mund të çojë në neglizhencën e masave të tjera thelbësore, pengojnë efektivitetin e tij për të zvogëluar rrezikun e transmetimit. (Organizata Botërore e Shëndetit, 2020)

Udhëzime shtesë mund të gjenden nga CDC dhe Kontrollit të Ndërmjetëm për pacientët me Coronavirus të Konfirmuar 2019 (COVID-19) (Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, 2020).

### **Rekomandim për kujdesin e pacienteve ambulator**

Parimet themelore të parandalimit dhe kontrollit të infeksionit dhe masat paraprake standarde duhet të zbatohen në të gjitha institucionet e kujdesit shëndetësor, përfshirë kujdesin ambulator dhe kujdesin parësor. Për infeksionin COVID-19, masat e mëposhtme duhet të adoptohen:

- Triazhi dhe diagnostikimi i hershëm;
- Theksimi për higjienën e duarve, higjienën respiratore dhe maskave mjekësore që duhen përdorur nga pacientët me simptoma të frymëmarrjes;
- Përdorimi i duhur i masave paraprake të kontaktit për të gjitha rastet e dyshuara;
- Prioriteti i kujdesit për pacientët simptomatikë;
- Kur pacientëve simptomatikë u kërkohet të presin, sigurohuni që ata kanë një zonë të veçantë të pritjes;
- Edukoni pacientët dhe familjet për njohjen e hershme të simptomave, masat paraprake themelore që duhet të përdoren dhe në cilin institucion shëndetësor duhet t'i referohen. (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2020)

### **Veprimet në barnatore komunitare dhe këshillimi i pacientëve**

Për shkak të qasjes së tyre dhe shpërndarjes së madhe gjeografike në shumicën e vendeve, barnatoret në komunitet shpesh janë pika e parë e kontaktit të publikut me sistemin e kujdesit shëndetësor - dhe kjo përfshin situata të shpërthimit të sëmundjeve dhe pandemive. Prandaj, barnatoret kanë një rol të rëndësishëm jo vetëm në sigurimin e qasjes në barna dhe pajisje mjekësore, por edhe në shëndetin publik, gjegjësisht duke informuar publikun për masat parandaluese, këshillimin për ndryshimet në sjellje dhe në vlerësimin e rrezikut, zbulimin e hershëm dhe referimin e individëve me një rrezik më të lartë të infektimit.

Është e rëndësishme që farmacistët të ofrojnë siguri për publikun në përgjithësi, në mënyrë që njerëzit të mbrojnë veten dhe të tjerët bazuar në dëshmi shkencore dhe sjellje racionale, dhe të mos kenë panik.

Në të gjitha rastet, është e rëndësishme që farmacistët dhe personeli i barnatores të mbrojnë veten nga infeksioni duke mbajtur një distancë të sigurt nga pacientët dhe pacientët/qytetarët dhe që shpesh të dezinfektojnë çdo sipërfaqe që mund të preket nga ata.

Meqenëse infeksioni mund të ndodhë nga individë asimptomatikë ose para-simptomatikë (Ruiyun Li, 2020), rekomandohet masa paraprake me të gjithë klientët dhe pacientët që hyjnë në farmaci.

Bazuar në vlerësimin e simptomave të një individi dhe historisë së fundit të udhëtimeve dhe / ose kontaktit me raste të konfirmuara ose të dyshuara të COVID-19, farmacistët duhet të vlerësojnë rrezikun dhe të ndërhyjnë / këshillojnë në përputhje me rrethanat, si në tabelën më poshtë. (Centro de Informação do Medicamento - CEDIME Portugal, 2020).

Duhet të konsiderohet se në një numër të madh vendesh, infeksioziteti me bazë komunitare është bërë forma kryesore e transmetimit të sëmundjes. Prandaj, ndërsa historia e udhëtimit nga zonat e prekura është ende një kriter i rëndësishëm në vendet me pak raste ose në një fazë fillestare të shpërthimit, ajo nuk do të jetë më një kriter përkatës për triazh në vendet me transmetim në komunitet

Kriteret	Veprimi
<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk ka simptoma (kollë, temperaturë ose vështirësi në frymëmarrje) DHE</li> <li>Pa kontakt të njohur kohët e fundit me raste të konfirmuara ose të dyshuara të COVID-19 dhe pa histori të fundit të udhëtimit në zonat e prekura</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ofroni siguri</li> <li>Theksoni masat parandaluese</li> <li>Rekomandoni distancimin shoqëror, izolimin në shtëpi dhe shmangien e udhëtimeve jo thelbësore (në vend dhe ndërkombëtare) kur është e mundur.</li> <li>Siguroni informacion dhe këshilla të bazuara në dëshmi (me gojë dhe / ose me shkrim)</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Simptomat (kollë, temperaturë ose vështirësi në frymëmarrje) DHE</li> <li>Pa kontakt të njohur kohët e fundit me raste të konfirmuara ose të dyshuara të COVID-19 dhe pa histori të fundit të udhëtimit në zonat e prekura</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ofroni siguri</li> <li>Informoni që rreziku i COVID-19 mund të ekzistojë</li> <li>Kur është e mundur, izoloni pacientin në një dhomë të veçantë</li> <li>Mos e ekzaminoni fizikisht pacientin</li> <li>Fuqizoni masat vetmbrojtëse, përfshirë përdorimin e një respiratori të përshtatshëm, dorëza dhe size</li> <li>Theksoni masat për të parandaluar transmetimin e mëtejshëm, përfshirë përdorimin e një maskë nga pacienti</li> <li>Rekomandoni distancë të rreptë sociale (përfshirë familjen dhe marrëdhëniet e ngushta), karantinën në shtëpi dhe shmangien e të gjithë udhëtimeve (në vend dhe ndërkombëtare) për të paktën 14 ditë</li> <li>Për individët e grupeve me rrezik më të lartë, këshilloni të kontaktoni numrin e</li> </ul>

	<p>urgjencës ose linjën telefonike ose institucionin përkatës të kujdesit shëndetësor për testimin dhe kujdesin vijues dhe trajtimin.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Siguroni informacion dhe këshilla të bazuara në dëshmi (me gojë dhe / ose me shkrim)</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk ka simptoma (kollë, temperaturë ose vështirësi në frymëmarrje)</li> </ul> <p>DHE</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontakt i njohur kohët e fundit me raste të konfirmuara ose të dyshuara të COVID-19 dhe / ose histori të udhëtimit në zonat e prekura</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ofroni siguri</li> <li>• Informoni që rreziku i COVID-19 mund të ekzistojë</li> <li>• Rekomandoni distancimin shoqëror, karantinën në shtëpi dhe shmangien e udhëtimeve jo thelbësore (në vend dhe ndërkombëtare) për të paktën 14 ditë</li> <li>• Rekomandoni gjurmimin e historisë së kontakteve</li> <li>• Në rast se simptomat shfaqen në 14 ditët pas kontaktit me rastin e konfirmuar ose të dyshuar, kontaktoni numrin e urgjencës ose linjën telefonike dhe ndiqni udhëzimet e duhura</li> <li>• Siguroni informacion dhe këshilla të bazuara në prova (me gojë dhe / ose me shkrim)</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Simptomat (kollë, temperaturë ose vështirësi në frymëmarrje)</li> </ul> <p>DHE</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontakt i njohur kohët e fundit me raste të konfirmuara ose të dyshuara të COVID-19 dhe / ose histori të udhëtimit në zonat e prekura</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ofroni siguri</li> <li>• Informoni që rreziku i COVID-19 mund të ekzistojë</li> <li>• Kur është e mundur, izoloni pacientin në një dhomë të veçantë</li> <li>• Mos e ekzaminoni fizikisht pacientin</li> <li>• Fuqizoni masat vetmbrojtëse, përfshirë përdorimin e një respiratori të përshtatshëm, dorëza dhe syze</li> <li>• Theksoni masat për të parandaluar transmetimin e mëtejshëm, përfshirë përdorimin e një maskë nga pacienti</li> <li>• Rekomandoni distancë të rreptë sociale (përfshirë familjen dhe marrëdhëniet e ngushta), karantinën në shtëpi dhe shmangien e të gjithë udhëtimeve (në vend dhe ndërkombëtare) për të paktën 14 ditë</li> <li>• Për individët e grupeve me rrezik më të lartë, këshilloni të kontaktoni numrin e urgjencës ose linjën telefonike ose institucionin përkatës të kujdesit shëndetësor për testimin dhe kujdesin vijues dhe trajtimin.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Siguroni informacion dhe këshilla të bazuara në dëshmi (me gojë dhe / ose me shkrim)</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Planet e pashmangshme të udhëtimit në zonat e prekura ose kontaktin me raste të konfirmuara ose të dyshuara të COVID-19</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ofroni siguri</li> <li>• Informoni për situatën dhe mënyrat e transmetimit</li> <li>• Theksoni masat parandaluese (veçanërisht larja e shpeshtë e duarve dhe shmangia e prekjes së fytyrës)</li> <li>• Theksoni masat e vetmbrojtjes, përfshirë përdorimin e një respiratori të përshtatshëm</li> <li>• Siguroni informacion dhe këshilla të bazuara në dëshmi (me gojë dhe / ose me shkrim)</li> </ul>

Personave që nuk ndjehen të mirë duhet të këshillohen që të qëndrojnë në shtëpi dhe të marrin masat e përgjithshme parandaluese të shumicës së infeksioneve të frymëmarrjes (shiko seksionin e dedikuar më poshtë).

Protokolli në tabelën e mësipërme është paraqitur edhe në formatin e një posteri që mund të shfaqet në barnatore për personelin e barnatores (i siguruar si dokument i veçantë në shumë gjuhë).

### Referimi dhe izolimi

Nëse dyshoni se dikush mund të ketë sindromën e sëmundjes akute të frymëmarrjes SARS-CoV-2, inkurajoni dhe mbështesni ata që të kërkojnë trajtim të menjëhershëm mjekësor në një institucion shëndetësor. OBSH nuk këshillon familjet ose komunitetet që të kujdesen për individët me simptoma të SARS-CoV-2 në shtëpi, përveç në rrethanat e përshkruara në seksionin specifik më poshtë.

Në drejtim të referimit të rasteve të dyshuara, autoritetet shëndetësore kombëtare, rajonale ose lokale mund të kenë hartuar protokolle për këtë, dhe është e rëndësishme që të njiheni me këto procedura, t'i ndiqni ato dhe të bashkëpunoni në zbatimin e tyre. Kjo mund të përfshijë izolimin, kur është e mundur, të rastit të dyshuar në një dhomë të veçantë dhe thirrjen e menjëhershme për shërbimet e duhura urgjente, të cilat duhet të dërgojnë një ekip profesionistësh të trajnuar dhe të mbrojtur siç duhet për të transportuar personin e dyshuar për infektion në institucionin e caktuar shëndetësor.

Kjo dhomë izolimi në barnatore duhet të ketë në mënyrë ideale toalet dhe inventar minimal për personin gjatë pritjes, në mënyrë që të shmanget kontaminimi dhe nevoja për të dekontaminuar është e domosdoshme. Deri sa është i izoluar personi duhet ta vërë maskën mjekësore. Pasi rasti i dyshuar të transferohet në një institucion shëndetësor, dhoma në të cilën pacienti është izoluar dhe çdo zonë e kontaminuar potencialisht si toaleti etj. duhet të pastrohet / dekontaminohet duke përdorur produkte dhe procedura të përshtatshme (shiko seksionin specifik më poshtë).



**Kujdesi në shtëpi për pacientët me infeksion të dyshuar SARS-CoV-2 që paraqesin simptoma të lehta**  
OBSh rekomandon që rastet e dyshuara të infeksionit SARS-CoV-2 të izoloohen dhe monitorohen në mjedisin spitalor për të pasur sigurinë dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor (në rast se simptomat e pacientëve përkeqësohen) dhe sigurinë e shëndetit publik.

Sidoqoftë, për disa arsye të mundshme, përfshirë situatat kur kujdesi spitalor nuk është i disponueshëm ose i pasigurt (p.sh. kapaciteti i kufizuar dhe burimet që nuk kanë mundësi për të përmbushur kërkesën për shërbime të kujdesit shëndetësor), ose në rast të refuzimit të informuar të hospitalizimit, vendet alternative (përfshirë shtëpinë e pacientit) për sigurimin e kujdesit shëndetësor mund të merren në konsideratë.

Nëse ekziston një arsye e tillë, pacientët me simptoma të lehta dhe pa ndonjë sëmundje kronike si sëmundjet e mushkërive ose zemrës, dështim të veshkave, apo ata me imunitet të komprometuar që i vendosin ata në rrezik më të madh të shfaqjes së komplikimeve mund të kujdesen në shtëpi.

Për më tepër, pacientët dhe anëtarët e familjes duhet të edukohen për higjienën personale, masat themelore të parandalimit dhe burimit të infeksionit, se si të kujdesen për anëtarin e dyshuar të infektuar të familjes sa më shumë të jetë e mundur, dhe se si të parandalojnë përhapjen e infeksionit në kontaktet shtëpiake. Ata duhet ti referohen rekomandimeve që mund të gjenden në udhëzimet specifike nga OBSh.

### **Barnatorja si burim i informacionit**

Farmacistët dhe asociacionet e tyre gjithashtu mund të krijojnë materiale informuese (posterë, fletëpalosje, faqe në internet, mesazhe me tekst, njoftime për aplikacione, etj) për komunitetin, përfshirë informacionin që përmbahet në këto udhëzime dhe çdo informacion tjetër që mund të jetë i rëndësishëm për nevojat lokale. Ata gjithashtu mund të organizojnë seanca pyetje dhe përgjigje në komunitet (shkolla, qendra komunitare, etj.).

FIP gjithashtu ka zhvilluar një poster të vogël për t'u shtypur me këshilla kryesore që farmacistët mund të ofrojnë në një varg skenarësh të ndryshëm (Shtojca 3).

FIP gjithashtu ka zhvilluar një faqe në internet ku mund të merren këto materiale. Ju lutemi vizitoni [www.fip.org/coronavirus](http://www.fip.org/coronavirus) në mënyrë periodike për azhurnime. Përveç materialeve në gjuhë të ndryshme, kjo faqe në internet përmban dokumente udhëzuese të hartuara nga Shoqata Kineze Farmaceutike në anglisht dhe kinezisht. Përveç këtyre burimeve, ju mund të gjeni një përmbledhje ndërkombëtare të burimeve të komunikimit në internet në gjuhë të ndryshme, të renditura në seksionin "Burime dhe informacione të tjera".

### **Testimi laboratorik për SARS-CoV-2 në rastet e dyshuara te njerëzit**

Aktualisht ka pak lloje testesh në dispozicion për diagnostikimin e COVID-19 (infeksioni SARS-COV-2), prodhuar në SH.B.A., në disa vende evropiane, Kinë, Kore dhe vende të tjera. Të gjitha bazohen në reaksione komplekse të zinxhirit të polimerazës (PCR) ose teknikat e transkriptimit të kundërt të zinxhirit të polimerazës (RT-PCR) teknikat që kanë cak pjesë të ndryshme të gjenomit viral.

Pas marrjes së strishos nga nazofaringu (qoftë hunda, gryka, dhe / ose aspirati nasofaringeal) që bëhet nga një infermier i kualifikuar ose personeli mjekësor, dhe pasi të pranohet nga laboratorët klinikë, testet

në dispozicion zakonisht marrin më pak se gjashtë orë për të dhënë një rezultat. Nganjëherë mund të kërkohej prioritizimi në periudhat kur kërkesa për teste diagnostikuese mund të tejkalojë kapacitetet laboratorike locale. Rregulla të tilla të prioritizimit duhet t'u kërkohej autoriteteve kompetente kombëtare ose rajonale.

Testet nuk janë të gjitha ekuivalente për sa i përket ndjeshmërisë për shkak të sekuencës gjenomike virale ose gjenit (et) të virusit që synohet. Aktualisht nuk ka të dhëna të besueshme shkencore në dispozicion për krijimin e një klasifikimi të ndjeshmërisë së testeve të ndryshme diagnostikuese në treg.

Deri më tani, nuk ka asnjë pajisje të shpejtë për testim (rapid test) të disponueshëm në treg, dhe barnatoret komunitare duhet t'i referojnë pacientët për testim tek autoritetet e tyre lokale ose kombëtare të shëndetit, në mënyrë që të dinë se ku të drejtohen pacientët për të kryer strishot për COVID-19 (SARS-COV- 2).

Për farmacistët që punojnë në laboratorët që mund të përfshihen në testimin diagnostik të mostrave nga rastet e dyshuara të njerëzve, OBSH ka zhvilluar një udhëzim të përkohshëm.

Personeli i laboratorit, për shkak të ekspozimit të tyre të drejtpërdrejtë ndaj pacientëve të potencial, edhe nëse janë asimptomatik, gjatë marrjes së mostrës së gjakut ose ndonjë lëngu tjetër biologjik, duhet të bëjë çdo përpjekje për të mbrojtur veten nga infektimi duke ndjekur rekomandimet e autoriteteve të tyre shëndetësore kombëtare (duke vënë maska kirurgjike dhe rekomandime të tjera).

Laboratorët klinikë duhet të jenë veçanërisht të kujdesshëm për të dërguar, ose të ofrojnë udhëzime tadekuate për praktikuesit klinikë për dërgimin e mostrave në laboratorët referentë të vendeve të tyre, dhe të pyesin rreth tyre pranë autoriteteve kompetente kombëtare. OBSH mund të ndihmojë shtetet anëtare në identifikimin e laboratorëve që mund ta sigurojnë këtë mbështetje. Të gjitha mostrat për testimin e COVID-19 duhet të paketohen dhe transportohen në përputhje me rregulloret e Kombeve të Bashkuara të kategorisë B për transportin. UN paketimit 3373 duhet të përdoret për transportin e mostrave.

Nëse kërkohej të krijoni një metodë diagnostikuese, personeli klinik i laboratorit duhet të pyesë në lidhje me rekomandimet dhe kërkesat e zbatueshme nga autoritetet e tyre kombëtare të shëndetit.

Udhëzime shtesë mund të gjenden në faqen e internetit të Qendrës së SHBA për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve - Udhëzime të përkohshme për mbledhjen, trajtimin dhe testimin e ekzemplarëve klinikë nga pacientët nën hetim (PUI) për vitin 2019 Novel Coronavirus (2019-nCoV). (Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjes, 2020)

**Në Kosovë këto informata mund të merren nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës–IKSHPK.**

### **Kontrolli i infeksionit: larja e duarve**

Barnatoret – farmacistët dhe teknikët e farmacisë mund të luajnë një rol të rëndësishëm të shëndetit publik duke rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e larjes së shpeshtë dhe të duhur të duarve dhe duke mbajtur sasi apo duke përgatitur antisepticët e duarve me bazë alkoolin.

Higjiena e duarve është thelbësore për të parandaluar përhapjen e virusit, dhe duhet të kryhet duke aplikuar teknikën e saktë të rekomanduar nga OBSH dhe duke përdorur ose sapun dhe ujë të rrjedhshëm ose një antiseptik dore me bazë alkoolin.

OBSH rekomandon që formulimet e tilla të kenë një përmbajtje alkooli prej 80% etanol ose 75% alkool izopropil.

### Si të përgatisni formulimet me bazë alkoli

Për informacion të detajuar se si të përgatisni formulimet e tilla, duke përfshirë metodat e llogaritjes dhe formulimit dhe një udhëzues hap pas hapi për prodhuesit vendorë, referojuni Udhëzuesit të OBSH-së për Prodhimin Lokal: Formulimet e rekomanduara nga WHO, të cilat ne i riprodhojmë në këto udhëzime - shih referenca (Shtojca 3).

Dokumenti është gjithashtu në dispozicion në:

[https://www.who.int/gpsc/5may/Guide\\_to\\_Local\\_Production.pdf](https://www.who.int/gpsc/5may/Guide_to_Local_Production.pdf)

### Menaxhimi i pastrimit dhe dezinfektimit

Për shkak se SARS-CoV-2 mund të transmetohet përmes pikave (spërkave) dhe kontaktit, çdo zonë e spitalit ose mjedisit të barnatores që mund të ketë qenë e kontaminuar me virusin, duhet të dezinfektohet. Studimet e mëparshme për SARS CoV dhe MERS-CoV sugjerojnë që SARS-CoV-2 është i ndjeshëm ndaj rrezatimit ultravjollcë dhe nxehtësisë (56 ° C për 30 minuta) (Cinatl J Rabenau HF, 2005). Gjithashtu, dezinfektuesit e mëposhtëm mund të inaktivizojnë në mënyrë efektive SARS-CoV-2: eter, 75% etanol, dezinfektues që përmbajnë klor, acidi peracetik dhe kloroformi. Klorheksidina nuk mund të inaktivizojë në mënyrë efektive SARS-CoV-2.

Kampf dhe bashkëpunëtorët kanë konstatuar gjithashtu nga analiza e 22 studimeve që koronavirusët njerëzorë si koronavirus i sindromës së rëndë akute të frymëmarrjes (SARS), koronavirus i sindromës së frymëmarrjes në Lindjen e Mesme (MERS) ose koronaviruset endemike njerëzore (HCoV) mund të qëndrojnë në sipërfaqe si metali, qelqi ose plastika deri në nëntë ditë, por mund të deaktivizohet në mënyrë efikase nga procedurat e dezinfektimit sipërfaqësor me etanol (edhe në 62-71%), 0,5% peroksid hidrogjeni ose 0.1% hypochlorit natriumi brenda një minute. (Kampf G, 2020)

Dëshmi më të reja nga studimet me SARS-CoV-2 (Neeltje van Doremalen, 2020), megjithatë, arritën në përfundimin se virusi mbetet i qëndrueshëm dhe i zbatueshëm në materiale të ndryshme deri në 72 orë, sipas tabelës më poshtë:

Lloji i sipërfaqes	Qëndrueshmëria	Gjysmë jeta
Aerosol	Deri në 3 orë	1.1 – 1.2 orë
Çeliku	Deri në 48-72 orë	5.6 orë
Kartoni/Letra	Deri në 24 orë	3.46 orë
Plastika	Deri në 72 orë	6.8 orë
Bakri	Deri në 4 orë	0.7 orë

Këto gjetje i bëjnë jehonë atyre me SARS-CoV-1, në të cilat këto forma të transmetimit u shoqëruan me përhapje nosokomiale dhe super-përhapje, dhe ato japin informacione për përpjekjet për zbutjen e pandemisë. (Neeltje van Doremalen, 2020)

Personeli i barnatores duhet të pastrojë dhe dezinfektojë mjedisin e punës, dhe artikujt dhe pajisjet në përputhje me udhëzimet dhe rregulloret përkatëse të pastrimit dhe dezinfektimit. (Shoqata Farmaceutike Kineze, 2020 (12 Shkurt))

Për një listë të dezinfektuesve dhe aplikimin e tyre në objektet e kontaminuara zakonisht, shihni Shtojcën 4.

Për më tepër, CDC-të e Shteteve të Bashkuara kanë botuar udhëzime me rekomandime të hollësishme për pastrimin dhe dezinfektimin e hapësirave ku qëndrojnë ose që mund të jenë në izolim personat që dyshohen ose ata të konfirmuar me COVID-19. Udhëzimi ka për qëllim kufizimin e mbijetesës së virusit në mjedise. Një dallim përkatës që ky dokument përcakton është edhe ai midis pastrimit dhe dezinfektimit:

- Pastrimi i referohet heqjes së mikrobeve dhe papastërtive nga sipërfaqet. Pastrimi nuk vret mikrobet, por duke i hequr ato, ul numrin e tyre dhe rrezikun e përhapjes së infeksionit.
- Dezinfektimi i referohet përdorimit të kimikateve për të vrarë mikrobet në sipërfaqe. Ky proces nuk pastron domosdoshmërisht sipërfaqet e ndyra ose largon mikrobet, por duke vrarë mikrobet në një sipërfaqe pas pastrimit, mund të ulë më tej rrezikun e përhapjes së infeksionit. (Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, 2020)

#### **Kontrolli i infeksionit: masat tjera të përkujdesjes**

1. Higjiena e frymëmarrjes duhet të praktikohet nga të gjithë, veçanërisht personat e sëmurë, në çdo kohë. Higjiena e frymëmarrjes i referohet mbulimit të gojës dhe hundës gjatë kollitjes ose teshtitjes duke përdorur maska mjekësore, maska të rrobave, ose bërri i përkulur, i ndjekur nga higjiena e duarve.
2. Hidhni materialet me të cilat kini mbuluar gojën ose hundën ose pastroni ato siç duhet pas përdorimit (p.sh. lani fauletat duke përdorur sapun dhe ujë).
3. Shmangni kontaktin e drejtpërdrejtë me lëngjet trupore, veçanërisht sekrecionet nga goja ose frymëmarrje dhe jashtëqitjen. Përdorni dorëza për një përdorim dhe mbrojtëse të syve për të siguruar kujdes oral dhe kur trajtoni jashtëqitje, urinë apo mbetje tjera. Kryeni higjenën e duarve para dhe pas heqjes së dorezave.
4. Doreza, maska dhe mbeturina të tjera të krijuara nga persona të sëmurë ose në kujdesin e personave të sëmurë duhet të vendosen në një enë në dhomën e personit të sëmurë përpara se të hidhen me mbeturina të tjera.
5. Shmangni llojet e tjera të ekspozimit të mundshëm ndaj personave të sëmurë ose sendeve të kontaminuara në mjedisin e tyre (p.sh. shmangni përdorimin e nje brushe të dhëmbëve të përbashkët, cigareve, enëve të ngrënies, pijeve, peshqirëve, rrobave larëse ose çarçafëve). Enët duhet të pastrohet me sapun dhe ujë, dhe mund të përdoren përsëri në vend që të hidhen.
6. Pastroni dhe dezinfektoni sipërfaqet e prekura shpesh, siç janë tavolinat afër krevateve, shtretërit dhe orenditë e tjera të dhomës së gjumit çdo ditë me dezinfektues të rregullt shtëpiak që përmban dezinfektantë.
7. Pastroni dhe dezinfektoni sipërfaqet e banjës të paktën një herë në ditë me dezinfektues shtëpiak.
8. Pastroni rrobat, mbulesat e shtratit, peshqirët e banjës dhe të duarve, etj., të personave të sëmurë, duke përdorur sapun të rregullt dhe ujë ose makinë larëse në 60-90 °C me pastrues të zakonshëm shtëpiak dhe thajini tërësisht. Vendosni rrobat e kontaminuara në një qese rrobash. Mos i tundni rrobat e ndotura. Shtetet mund të marrin në konsideratë masa për të siguruar që mbeturinat depozitohen në një deponi sanitare, dhe jo në një deponi të hapur të pa monitoruar,

kur kjo është e mundur. Mund të nevojiten masa shtesë për të parandaluar ripërdorimin johegjenik të dorezave dhe maskave dhe për të shmangur kontaktin e drejtpërdrejtë të lëkurës dhe rrobave me materialet e kontaminuara.

9. Përdorni doreza njëpërdorimëshe, size mbrojtse dhe veshje mbrojtëse (p.sh. veshjet plastike) kur pastroni ose trajtoni sipërfaqe, veshmbathje ose rroba të ndotura me lëngje trupore. Bëni higjienën e duarve para dhe pas heqjes së dorezave. (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2020)

Një dokument i rëndësishëm për tu lexuar si udhërrëfyes i përgjithshëm për parandalimin dhe kontrollin e shpërthimeve i prodhuar nga OBSH (Organizata Botërore e Shëndetësisë 2014)

### **Shqetësimet lehtësuese: udhëtimi**

Njerëzit mund të shqetësohen për mundësinë e udhëtimit në të njëjtin aeroplan, anije, autobus ose automjet tjetër me një person të infektuar me SARS-CoV-2, dhe mund të pyesin në barnatore për këtë. Pasi përhapja e COVID-19 po rritet në botë, popullata duhet të rekomandohet që të shtyjë të gjitha udhëtimet të cilat janë jo-thelbësore.

Publiku duhet të marrë parasysh këshillat shëndetësore më poshtë kur udhëton:

1. Shmangni udhëtimet në zonat ku ka një përhapje të përhapur në komunitet të virusit COVID-19;
2. Kur udhëtoni në vendet / zonat me transmetim aktiv të virusit COVID-19, shmangni kontaktin e ngushtë me personat me temperaturë ose simptoma të frymëmarrjes. Nëse është e pashmangshme të kontaktoni me ta, vini një maskë kirurgjike dhe vazhdoni ta bëni këtë deri në 14 ditë pas kthimit në vendin tuaj;
3. Shmangni vizitat në spitale. Nëse është e nevojshme të vizitoni një spital, vini një maskë kirurgjike dhe vëzhgoni higjienën e rreptë personale dhe të duarve;
4. Shmangni preken e kafshëve, shpendëve dhe mbetjeve/nevojave e tyre;
5. Shmangni vizitat në tregjet, tregjet e shpendëve të gjalla dhe fermat;
6. Mos konsumoni mish të shpendëve dhe mos vizitoni ambientet e ushqimit ku shërbehet mishi i shpendëve (shpendi game);
7. Respektoni rregullat e sigurisë ushqimore dhe higjienës, siç janë shmangia e konsumimit të produkteve shtazore të gjalla apo të papjekura, përfshirë qumështin, vezët dhe mishin, ose ushqimet të cilat mund të jenë të kontaminuara nga sekretet e kafshëve, sekretimet (si urina) ose produktet e kontaminuara, përveç nëse ato kanë qenë gatuar siç duhet, lahet ose qëruar mirë;
8. Nëse nuk ndjeheni mirë kur udhëtoni, veçanërisht nëse keni temperaturë ose kollë, vini maskë kirurgjike, informoni personelin e hotelit ose kërkoni këshillë mjekësore menjëherë; dhe
9. Pasi të ktheheni në vendin tuaj, këshillohuni menjëherë me një profesionist mjekësor nëse keni temperaturë ose simptoma të tjera, merrni iniciativën për t'i informuar ata për çdo histori të re të udhëtimit dhe çdo ekspozim ndaj kafshëve, dhe vini një maskë kirurgjike për të ndihmuar në parandalimin e përhapjes së sëmundjes.

Është e dobishme t'i kujtoni ata se përhapja nga personi në person i COVID-19 mendohet se ndodhë kryesisht përmes pikave (spërkave) të frymëmarrjes të prodhuara kur një person i infektuar kollitet ose teshtit, të ngjashme me atë se si përhapen gripi dhe patogjenët e tjerë të frymëmarrjes. Si e tillë, kjo mund të ndodhë gjatë udhëtimit.

Kështu që, nëse një person ka temperaturë dhe kollë, duhet të këshillohet të shmangë udhëtimet.

Disa vende po marrin masa për të kontrolluar udhëtarët në aeroporte dhe porte me qëllim zbulimin e hershëm të udhëtarëve simptomatikë për vlerësim dhe trajtim të mëtutjeshëm, dhe kështu parandalojnë eksportimin e sëmundjes duke minimizuar ndërhyrjen në trafikun ndërkombëtar.

Ekzaminimi përfshin: kontrollimin e shenjave dhe simptomave (temperaturë mbi 38 °C, kollë); intervistimi i udhëtarëve me simptoma të infeksionit respirator që vijnë nga zonat e prekura; udhëzimi i udhëtarëve simptomatikë në ekzaminim të mëtejshëm mjekësor i pasuar nga testimi për SARS-CoV-2; dhe mbajtja e rasteve të konfirmuara nën izolim dhe trajtim. (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2020)

## **Personeli i barnatores**

Megjithëse është e rëndësishme që të gjithë personeli i barnatores të jetë i njoftuar me këto udhëzime dhe këshilla, vlerësimi i rrezikut të një pacienti nga COVID-19 duhet të udhëhiqet nga farmacistët. Ata janë gjithashtu përgjegjës për referimin e duhur të rasteve të dyshuara në institucionin përkatës të kujdesit shëndetësor.

Natyrisht, ekziston mundësia e ekspozimit të farmacistëve ndaj COVID-19, sepse ata bashkëveprojnë me pacientë të cilët ndoshta janë të infektuar, prandaj profesionistët shëndetësorë duhet të marrin masa për të mbrojtur veten gjithashtu.

I gjithë ekipi i barnatores duhet të jetë i trajnuar jo vetëm të dijë se çfarë të bëjë kur ekziston dyshimi për infeksion nga COVID-19, por edhe për të promovuar masa për të parandaluar infeksionin në publik. Prandaj, rekomandohet që i gjithë ekipi i barnatoreve të trajnohet në:

- Informacion teknik dhe shkencor për COVID-19, veçanërisht për simptomat, periudhën e inkubacionit dhe mënyrën e transmetimit të virusit;
- Informacion epidemiologjik për zonat e prekura. Për shifrat e azhurnuara të numrit të rasteve të konfirmuara për secilin vend, vizitoni faqen në internet <https://www.worldometers.info/coronavirus/> dhe / ose faqen në internet të krijuar nga Qendra për Shkencë dhe Inxhinieri e Sistemeve në Universitetin Johns Hopkins.
- Informacione për masat parandaluese përfshirë informacionin për dezinfektuesit dhe higjenën e duhur të duarve;
- Informacione se si të procedohet në një rast të dyshuar, përfshirë strategjitë që duhet të zbatohet secila barnatore;
- Materialet në dispozicion për të mbështetur veprimin (broshurat e informacionit, tabelat e rrjedhës së veprimit dhe faqet e internetit të sakta për informacionin). (Centro de Informação do Medicamento - CEDIME Portugal, 2020)

## **Përgjigje për pyetje të shpeshta nga popullata dhe pacientët**

### **Ç'është koronavirusi i ri?**

Koronavirusi i ri (nCoV) është ai lloj që nuk është identifikuar më parë. SARS-CoV-2 nuk është i njëjtë me koronaviruset që qarkullojnë zakonisht tek njerëzit dhe shkaktojnë sëmundje të lehtë, si ftohja e zakonshme. Diagnostikimi me koronavirus 229E, NL63, OC43, ose HKU1 nuk është e njëjtë me diagnostikimin SARS-CoV-2. Këta janë virusë të ndryshëm dhe për pacientët me SARS-CoV-2 do të ketë vlerësohen dhe kujdesje të ndryshme nga ajo për pacientët me diagnozë të zakonshme të koronavirusit. (Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, 2020)

### **Cili është burimi i SARS-CoV-2?**

Profesionistët shëndetësorë dhe shëndetit publik po punojnë shumë për të identifikuar burimin e SARS-CoV-2. Koronaviruset janë një familje e madhe virusesh, disa duke shkaktuar sëmundje te njerëzit dhe të tjerët që qarkullojnë te kafshët, përfshirë devetë, macet dhe lakuriqët. Analiza e pëmës gjenetike të këtij



virusi është në vazhdim e sipër për të përcaktuar burimin specifik të virusit dhe lakuriqët dyshohet për shkak të ngjashmërisë së virusit dhe koronaviruseve që më parë janë gjetur në disa specie të lakuriqëve. Sindromi i rëndë akut respirator (SARS), një tjetër koronavirus që infekton njerëzit, vjen nga macet, ndërsa Sindromi Respirator i Lindjes së Mesme (MERS) vjen nga devetë. (Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, 2020)

### **Si përhapet virusi?**

Ky virus ndoshta fillimisht ka dalë nga një burim shtazor por tani po përhapet nga një person në tjetrin. Është e rëndësishme të theksohet se përhapja nga personi në person ndryshon. Disa viruse janë shumë ngjitës (si fruthi), ndërsa viruset e tjerë janë më pak të tillë. Aktualisht, është e paqartë se sa lehtë ose në mënyrë të qëndrueshme përhapet SARS-CoV-2 mes njerëzve. (Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, 2020)

### **A mund të ngjitet COVID-19 nga një person që nuk shfaq simptoma?**

Transmisioni ose ngjitja e SARS-CoV-2 nga persona asimptomatikë (ose individë brenda periudhës së inkubacionit) është përshkruar. Sidoqoftë, shkalla në të cilën ndodh kjo mbetet e panjohur. Ekzaminimi serologjik në shkallë të gjerë mund të jetë në gjendje të sigurojë të kuptuar më të mirë të fushëveprimit të infeksioneve asimptomatike dhe të informojë analizën epidemiologjike. (McIntosh, UpToDate Coronavirus sëmundja 2019 (COVID-19): Transmisioni, 2020)

### **A mundet që një grua shtatzënë të transmetojë virusin tek fetusin?**

Ka pak informata në dispozicion në lidhje me COVID-19 gjatë shtatzënësisë. Transmetimi intrauterin ose perinatal nuk është identifikuar. Në dy raporte që përfshinin gjithsej 18 gra shtatzëna me pneumoni të të dyshuar ose të konfirmuar për COVID-19, nuk kishte asnjë deshmi laboratorike për transmetimin e virusit në neonat. Sidoqoftë, dy raste neonatale të infeksionit janë të dokumentuara. Në një rast, diagnoza u bë në ditën e 17 të jetës, pas kontaktit të ngushtë me nënën e foshnjës dhe maminë, të cilat të dyja ishin të infektuar me virusin. Rasti tjetër u diagnostikua 36 orë pas lindjes; burimi dhe koha e transmetimit në atë rast ishin të paqarta. (McIntosh, sëmundja Coronavirus 2019 (COVID-19) - Situa speciale: Gratë shtatzëna, 2020)

### **A mund të transmetohet virusi nga nëna tek fëmija përmes ushqyerjes me gji?**

Në studime të kufizuara për gratë me COVID-19 dhe tjetër infeksion koronavirus, Sindromi i rëndë Akut i respirator (SARS-CoV), virusi nuk është zbuluar në qumështin e gjirit; megjithatë nuk dihet nëse nënat me COVID-19 mund ta transmetojnë virusin përmes qumështit të gjirit. Qumështi i gjirit siguron mbrojtje ndaj shumë sëmundjeve. Ka përjashtime të rralla kur ushqyerja me gji ose ushqyerja me qumësht gjiri të nxjerrë përmes pompës nuk rekomandohet. CDC nuk ka udhëzime specifike për ushqyerjen në gji gjatë infeksionit me viruse të ngjashme si SARS-CoV ose Sindromi i frymëmarrjes në Lindjen e Mesme (MERS-CoV) gjithashtu të dy këta koronaviruse. Në një situatë të ngjashme me COVID-19, CDC rekomandon që një nënë me grip të vazhdojë ushqyerjen në gji ose të ushqejë foshnjën me qumësht gjiri të nxjerrë përmes pompës, përderisa merr masa paraprake për të shmangur përhapjen e virusit tek foshnja e saj. Duke pasur parasysh nivelet e ulëta të transmetimit të viruseve të frymëmarrjes përmes qumështit të

gjirit, Organizata Botërore e Shëndetit deklaron që nënat me COVID-19 mund të ushqejnë foshnjat në gji. (Akademia e Mjekësisë së Ushqyerjes me Gji, 2020).

### **A është SARS-CoV-2 i njëjtë me virusin MERS-CoV ose SARS?**

Jo. Koronaviruset janë një familje e madhe virusesh, disa duke shkaktuar sëmundje te njerëzit dhe të tjerë që qarkullojnë midis kafshëve, përfshirë deve, mace dhe lakuriqët. SARS-CoV-2 i shfaqur kohët e fundit nuk është i njëjtë me koronaviruset që shkaktojnë MERS ose SARS. Sidoqoftë, analizat gjenetike sugjerojnë se ajo doli nga një virus i ndërlidhur me atë që shkaktoi SARS. Në vazhdim po bëhen hulumtime të mëtejme për të mësuar më shumë. Kjo është një situatë që zhvillohet me shpejtësi dhe informacioni do të azhurnohet pasi të bëhet i disponueshëm.

(Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, 2020)

### **Kam temperaturë dhe kollë. A mund të jetë koronavirusi i ri?**

Nëse keni qenë në kontakt të ngushtë me një rast të konfirmuar të COVID-19, mund të keni, dhe ju duhet të testoheni. Simptomat e COVID-19 nuk janë specifike për këtë sëmundje dhe mund të jenë mjaft të ngjashme me ato të gripit sezonal ose gjendjeve të tjera. Sidoqoftë, nëse keni ndonjë nga simptomat, ju këshillohet të izoloheni në shtëpi dhe të ndiqni udhëzimet e autoriteteve tuaja shëndetësore kombëtare. Nëse jeni më të vjetër se 65 vjeç ose keni gjendje të tjera siç janë sëmundjet kardiovaskulare, diabeti, sëmundjet kronike të frymëmarrjes, kanceri ose gjendje të tjera (kongjenitale ose të fituara) që mund të kompromentojnë përgjigjen tuaj imunitare, mund të keni rrezik më të lartë për të zhvilluar forma më të rënda të sëmundjes, dhe këshillohet që të kërkonijë kujdes të duhur mjekësor.

### **Çka mund të bëj për të mbrojtur veten nga infeksioni?**

Masat e zakonshme të higjienës duhet të ndiqen për të parandaluar përhapjen e infeksioneve: larja e rregullt e duarve, mbulimi i gojës dhe hundës kur kolliteni dhe teshtitni, gatuajeni plotësisht mishin dhe vezët. Shmangni kontaktin e ngushtë me këdo që tregon simptoma të sëmundjes së frymëmarrjes si kollitja dhe teshtitja. (Shoqata Farmaceutike Mbretërore, 2020)

### **A ka ndonjë bar specifik për të parandaluar ose trajtuar SARS-CoV-2?**

Deri më tani, nuk ka asnjë bar specifik të rekomanduar për të parandaluar ose trajtuar SARS-CoV-2. Sidoqoftë, ata të infektuar me virus duhet të kenë kujdes adekuat për të lehtësuar dhe trajtuar simptomat, dhe ata me sëmundje të rëndë duhet të marrin kujdes mbështetës të optimizuar. Disa trajtime specifike janë nën hetim dhe do të testohen përmes provave klinike. OBSH po ndihmon për të përshpejtuar përpjekjet e kërkimit dhe zhvillimit me një gamë partnerësh. (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2020)

Nëse dëshironi të mbronijë veten nga infektimi me koronavirusin e ri, duhet të ruani higjienën bazë të duarve dhe frymëmarrjes, dhe praktikatat e sigurta të ushqimit dhe të shmangni kontaktin e ngushtë, kur është e mundur, me këdo që tregon simptoma të sëmundjes së frymëmarrjes, si kollitja dhe teshtitja.

Masat e mëposhtme nuk rekomandohen posaçërisht si mjete për SARS-CoV-2 sepse ato nuk janë efektive për të mbrojtur veten tuaj dhe mund të jenë edhe të dëmshme:

- Marrja e vitaminës C
- Pirja e çajrave bimorë tradicionale
- Vënia e maskave të shumta për të maksimizuar mbrojtjen
- Vetë-mjekimi me barna si psh me antibiotikë



Në çdo rast, nëse keni temperaturë, kollë dhe vështirësi në frymëmarrje kërkoni kujdes mjekësor sa më parë për të zvogëluar rrezikun e zhvillimit të një infeksioni më të rëndë dhe sigurohuni që të tregoni me kujdes për udhëtimet që keni pasur.

### **A ju mbrojnë vaksinat kundër pneumonisë kundër SARS-CoV-2?**

Jo. Vaksinat kundër pneumonisë, siç është vakcina pneumokok (PV) dhe vakcina e llojit Haemophilus influenza B (Hib), nuk ofrojnë mbrojtje kundër SARS-CoV-2. Virusi është aq i ri dhe i ndryshëm sa që duhet të zhvillohet vakcina specifike. Studiuesit po përpiqen të zhvillojnë një të tillë dhe OBSH po mbështet përpjekjet e tyre. Edhe pse PV dhe Hib nuk janë efektive kundër SARS-CoV-2, vaksinimi kundër sëmundjeve të frymëmarrjes rekomandohet shumë për të mbrojtur shëndetin. (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2020)

### **A janë antibiotikët efektive në trajtimin e SARS-CoV-2?**

Jo, antibiotikët nuk veprojnë kundër viruseve; ata veprojnë vetëm në infeksione bakteriale. SARS-CoV-2 është një virus dhe, për këtë arsye, antibiotikët nuk duhet të përdoren si një mjet parandalimi ose trajtimi. Sidoqoftë, nëse jeni në spital me SARS-CoV-2, mund të merrni antibiotikë sepse bashkë-infeksioni bakterial është i mundur. (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2020)

### **A duhet të ndërpritet trajtimi me ACE inhibitorë ose bllokuesit e receptorëve të angiotenzinës për shkak të një rreziku të shtuar të ashpërsisë së COVID-19?**

Nuk ka asnjë dëshmi për të mbështetur pohimin dhe se trajtimi me ACE inhibitorë (ACEi) ose bllokuesit e receptorëve të angiotenzinës (ARB) mund të predispozojnë individët për rezultate të pafavorshme nëse ata infektohen me COVID-19. Shoqata të ndryshme shkencore dhe profesionale kanë deklaruar që pacientët duhet të vazhdojnë trajtimin me ACEi dhe ARB përveç nëse këshillohen në mënyrë specifike që të ndalin trajtimin nga ekipi i tyre mjekësor. (Shoqata Britanike Kardiovaskulare dhe Shoqata Britanike për Dëshim të Zemrës, 2020).

### **A është i sigurt përdorimi i barnave anti-inflamatore jo-steroidale duke përfshirë ibuprofen për të menaxhuar ethe dhe dhimbje te pacientët COVID-19?**

Aktualisht nuk ka dëshmi përfundimtare për të krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë midis përdorimit të barnave anti-inflamatore jo-steroidale (përfshirë ibuprofen) dhe rritjes së rrezikut të infeksionit ose ashpërsisë së sëmundjes. (Agjensia Evropiane e Barnave, 2020)

### **A mund të ndryshojë (pësojë mutacion) virusi përpara se të zhvillohet ndonjë trajtim apo vakcina?**

Po. Në fakt, virusi duket se tashmë ka ndryshuar, duke çuar në të paktën dy shtame të ndryshme. Analizat gjenetike të popullsisë së 103 gjenomeve SARS-CoV-2 treguan se këto viruse evolucionuan në dy lloje kryesore (të përcaktuara L dhe S). Megjithatë lloji L (~70%) është më i përhapur se lloji S (~30%), lloji S u konstatua se ishte versioni bazë. (Xiaolu Tang, 2020)

Derisa të dy llojet luajnë një pjesë në shpërthimin e tanishëm, përhapja më e lartë e "tipit L" sugjeron që është më agresive. Sidoqoftë, është e rëndësishme të mbani në mend që viruset ndryshojnë gjatë gjithë kohës dhe që jo të gjitha mutacionet janë tregues i ashpërsisë së sëmundjes ose shkallës së transmetimit. Në fakt, dallimet midis dy llojeve të koronavirusit të ri janë aq të vogla sa studiuesit nuk kanë dëshirë t'i bëjnë klasifikimin e tyre si "shtame" të veçanta. Duke pasur parasysh që grupe të shumta në botën po punojnë për një vaksinë, të dihet numri i saktë i shtameve (ose llojet) e virusit është thelbësore sepse, për të qenë efektive, vakcina eventuale do të duhet të synojë tipare të pranishme në të gjitha shtamet e njohura (ose llojet). Për fat të mirë, shumë nga ndryshimet gjenetike të identifikuar nuk kanë gjasa të ndikojnë në prodhimin e proteinave, do të thotë se nuk duhet të ketë ndryshime të rëndësishme në mënyrën se si funksionon virusi ose simptomat që shkakton. (Technology.org, 2020).

### **A mund të ndihmojnë multivitaminat dhe imuno-përforcuesit në mbrojtjen e individëve nga virusi?**

Nuk ka asnjë dëshmi se ndonjë prej këtyre strategjive do të mbingarkojë imunitetin. Ndërsa është e vërtetë që fiziologjia jonë kërkon që vitaminat dhe mineralet (të tilla si vitaminat A, C dhe zinku) të funksionojnë normalisht, doza më të larta nuk janë treguar që e bëjnë sistemin të funksionojë më mirë. Çdo pjesë e trupit, përfshirë sistemin imunitar, funksionon më mirë kur mbrohet nga sulmet mjedisore dhe forcohet nga strategjitë e jetesës së shëndetshme, si në vijim:

- Mos pirja e duhanit;
